



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 6 regjistër (JR)

Datë 26.01.2021

Nr. 32 i vendimit

Datë 24.07.2023

VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga gjyqtarët:

Natasha Mulaj	Kryesuese
Sokol Çomo	Relator
Ina Rama	Anëtare
Rezarta Schuetz	Anëtare
Mimoza Tasi	Anëtare

– mori në shqyrtim në seancë gjyqësore publike, më datë 24.07.2023, ora 09:30, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në Tiranë, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar Ferdinando Buatier De Mongeot, me Sekretare Gjyqësore Anisa Sejdini, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit nr. 6/2021 (JR), datë 26.01.2021, që i përket:

ANKUES: Komisioneri Publik Florian Ballhysa.

OBJEKTI: Shqyrtimi i vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 276, datë 21.07.2020, që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. Irena Brahimi.

BAZA LIGJORE: Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, nenet C, pika 2 dhe F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës; neni 63 i ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

ANKUESE: Subjekti i rivlerësimit, znj. Irena Brahimi.

OBJEKTI: Kundërshtimi pjesërisht i vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 276, datë 21.07.2020, sa u takon përfundimeve të arritura në pjesën arsyetuese.

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në seancë gjyqësore publike, me praninë e palëve, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), dëgjoji Komisionerin Publik i cili përfundimisht kërkoi ndryshimin e vendimit nr. 276, datë 21.07.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit për subjektin e rivlerësimit, znj. Irena Brahimi, dhe shkarkimin e saj nga detyra, bazuar në nenin 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, dëgjoji subjektin e rivlerësimit, znj. Irena Brahimi, e cila përfundimisht kërkoi lënien në fuqi të vendimit objekt shqyrtimi, dëgjoji gjyqtarin relator të çështjes Sokol Çomo, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit, znj. Irena Brahimi, prej vitit 1997 e në vijim, ka ushtruar detyrën e gjyqtares dhe në momentin e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 84/2016, ushtronte detyrën e gjyqtares në Gjykatën e Apelit Gjyrokastër. Për rrjedhojë, në zbatim të nenit 179/b, pika 3 e Kushtetutës, ajo iu nënshtrua procesit të rivlerësimit kalimtar *ex officio*.
2. Subjekti i rivlerësimit ka plotësuar dhe dërguar pranë institucioneve kompetente dhe brenda afatit ligjor¹, në përputhje me nenet 31, pika 1, 35, pika 1 dhe 41, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, përkatësisht deklaratën e pasurisë², deklaratën për kontrollin e figurës³, si dhe formularin për vetëvlerësimin profesional⁴.
3. Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”), pasi kreu procedurën e kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, në zbatim të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, dërgoi pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (në vijim “Komisioni”) një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar, duke konstatuar se:

¹ Afati ligjor, prej 30 ditësh nga hyrja në fuqi e ligjit për dorëzimin e deklaratës së pasurisë, kontrollit të figurës dhe formularit të vetëvlerësimit profesional, ka përfunduar më datë 31.01.2017.

² Dorëzuar pranë ILDKPKI-së më datë 25.01.2017, sipas vërtetimit të ILDKPKI-së me nr. {***} prot., datë 25.01.2017. Të njëjtën datë mban dhe deklarata e pasurisë në rubrikën përkatëse.

³ Referuar “Deklaratës për kontrollin e figurës”, dorëzimi është kryer më datë 23.01.2017.

⁴ Referuar raportit nr. {***} prot., datë 14.02.2019, të KLGj-së “Për analizimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit Irena Brahimi për periudhën 08.10.2013 deri më 08.10.2016”, subjekti i rivlerësimit ka dorëzuar formularin e vetëdeklarimit më datë 25.01.2017.

- (i) Deklarimi është i saktë, në përputhje me ligjin.
- (ii) Ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë.
- (iii) Nuk ka kryer fshehje të pasurisë.
- (iv) Nuk ka kryer deklaram të rremë.
- (v) Subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

4. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim “DSIK”) kreu kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit me anë të verifikimit të deklarameve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti i rivlerësimit kishte kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin Dh të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016, dhe dërgoi një raport pranë Komisionit, bazuar në nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, me anë të të cilit konstatoi përshtatshmërinë e subjektit të rivlerësimit për vazhdimin e detyrës. Në datën 02.08.2019, DSIK-ja ka dërguar një raport të dytë të përditësuar në të cilin është shprehur ndër të tjera: *Bazuar në parashikimet e bëra në Aneksin “Rivlerësimi kalimtar i gjyqtarëve dhe prokurorëve”, neni Dh, “Kontrolli i figurës”, pika 2 që përcakton si periudhë të vlerësimit për kontrollin e figurës datën 01.01.2012, nisur nga të dhënat e sipërcituara, veprimtaria e dyshuar për veprime korruptive e abuzive me detyrën për subjektin e rivlerësimit i përket një periudhe para këtij afati. [...] Sa më sipër, bazuar te të dhënat e përcjella nga autoritetet verifikuese, arsyetohet se nuk ndodhemi para ndonjë rrethane apo fakti të qenësishëm që të mund të vërtetojë, përfshirjen në veprimtari të kundërligjshme të subjektit të rivlerësimit I. S. B. dhe mundësinë e ndryshimit të konstatimit për këtë subjekt rivlerësimi. Në konkluzion, grupi i punës u shpreh: Në konfirmim të konstatimit fillestar për përshtatshmëri në vijimin e ushtrimit të detyrës për subjektin e rivlerësimit I. S. B., gjykojmë që për rastin në fjalë, konkluzioni të mbetet në vlerësimin tuaj nën dritën e informacioneve të tjera që mund të dispononi si pjesë e gjetjeve/konstatimeve të dala nga procedurat e hetimit administrativ që po kryhen ndaj subjektit të rivlerësimit.*
5. Këshilli i Lartë Gjyqësor (në vijim “KLGj”) ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit nëpërmjet rishikimit të dokumenteve ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt rivlerësimi, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe të 5 dokumenteve të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor dhe ka dërguar pranë Komisionit një raport të hollësishëm për subjektin e rivlerësimit, bazuar në nenin 43 të ligjit nr. 84/2016.
6. Bazuar në nenin Ç, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 4 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, pasi administroi raportet e vlerësimit të hartuara për subjektin e rivlerësimit nga ILDKPKI-ja, DSIK-ja dhe KLGj-ja, kreu procesin e rivlerësimit kalimtar për subjektin në fjalë, bazuar në të tria kriteret e vlerësimit (vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale), duke marrë vendimin nr. 276, datë 21.07.2020.

II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

7. Komisioni, me vendimin nr. 276, datë 21.07.2020, vendosi: “Konfirmimin e subjektit të rivlerësimit, znj. Irena Brahimi, me detyrë gjyqtare në Gjykatën e Apelit Gjjirokastër [...]”.
8. Ky vendim është marrë bazuar në nenet 58, pika 1, shkronja “a” dhe 59, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, në vijim të konkluzioneve të mëposhtme, për secilin prej tri kritereve të rivlerësimit.

8.1 *Në lidhje me vlerësimin e pasurisë së subjektit, pasi janë analizuar dhe vlerësuar nga trupi gjykues edhe pretendimet e subjektit të rivlerësimit, nga analiza financiare e kryer nga Njësia e Shërbimit Ligjor të Komisionit, ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit ka pasur një mangësi financiare, në total në shumën prej – 526.113 lekësh, përgjatë periudhës 2003 – 2016, dhe – 301.701 lekësh për periudhën përpara vitit 2003. Në përfundim, trupi gjykues, pas analizimit të provave shtesë të paraqitura nga subjekti dhe vlerësimeve përkatëse të kryera në raport me ligjin e zbatueshëm, çmon se – duke e parë nën dritën e parimit të proporcionalitetit dhe në tërësinë e tij kriterin e pasurisë për këtë subjekt rivlerësimi – kjo mungesë financiare, si dhe pasaktësitë e konstatuara në deklarime, në vetvete, nuk kanë një peshë të tillë që të mund të përbëjë shkaqe të mjaftueshme për aplikimin e masës së shkarkimit nga detyra, të znj. Irena Brahimi, sipas parashikimeve të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe/ose në pikën 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84.2016.*

8.2 *Në lidhje me kontrollin e figurës, Komisioni – pas hetimit administrativ dhe rivlerësimit të kryer, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin Dh të Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 38 të ligjit nr. 84/2016 dhe bazuar në dokumentet e administruara, si dhe mbi dokumentet dhe informacionet e klasifikuara, të verifikuara nga trupi gjykues pranë organeve ligjzbatuese – në vlerësimin e kriterit të kontrollit të figurës, në tërësi, arrin në përfundimin se nuk janë gjetur fakte apo rrethana bindëse, të mjaftueshme për të konkluduar për ndonjë favorizim apo ndikim të paligjshëm nga subjekti, nëpërmjet funksionit të tij, apo mbi ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme, me ndonjë person të përfshirë në krimin e organizuar. Komisioni, në këto kushte, në lidhje me kriterin e kontrollit të figurës, nuk i konsideron të mjaftueshme informacionet, indiciet dhe dyshimet e ngritura për të konkluduar për papërshtatshmërinë e subjektit të rivlerësimit për vijueshmërinë e funksionit të tij. Për rrjedhojë, nuk u gjetën elemente të mjaftueshme që të përbënin shkak për shkarkimin e subjektit të rivlerësimit, në zbatim të pikës 2 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.*

8.3 *Në lidhje me vlerësimin e aftësive profesionale, nga kryerja e një vlerësimi të përgjithshëm të kriterit të aftësive profesionale, trupi gjykues çmon se, nisur nga gjendja faktiko-ligjore e konstatuar dhe argumentuar më lart, si dhe nga konstatimet e bëra nga KLGj-ja, lidhur me mënyrën e të punuarit (modus operandi) të subjektit – problematikat që kanë rezultuar nuk mund të klasifikohen si shkelje apo mangësi të rënda profesionale. Në këto kushte, trupi gjykues çmon se rrethanat e sipërcituara nuk përbëjnë shkaqe të mjaftueshme për të konkluduar për papërshtatshmërinë profesionale të subjektit të rivlerësimit dhe, si rrjedhim, mbërrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit, znj. Irena Brahimi, ka arritur së paku nivelin minimal*

kualifikues për vlerësimin e aftësive profesionale, sipas parashikimit ligjor që e përcakton atë si prag kualifikimi.

9. Në datën 19.10.2020, Komisioni mori vendimin nr. 276/1 “Për korrigjimin e vendimit nr. 276, datë 21.07.2020”, me anë të të cilit vendosi që në dispozitivin e vendimit nr. 276, datë 21.07.2020, pas pikës 1, të shtohet pika 2, me përmbajtje: *Transferimin e çështjes civile me palë ndërgjyqëse: paditës A. Ç. e të paditur: Zyra Përmbartimore “{***}” ShPK dhe me objekt: “Kundërshtim i veprimeve përmbartimore”, të shqyrtuar në Gjykatën e Apelit Gjirokastrë, dhe të përfunduar me vendimin nr. {***}, datë 12.5.2015, pranë organit kompetent për inspektimin e shkaqeve që mund të përbëjnë shkelje disiplinore, bazuar në pikën 4 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016. [...]*

III. Pretendimet në Kolegj

A. Sipas ankimit të Komisionerit Publik

10. Komisioneri Publik Florian Ballhysa, më datë 23.10.2020, ushtroi ankim ndaj vendimit të Komisionit nr. 276, datë 21.07.2020, për subjektin e rivlerësimit, znj. Irena Brahimi, duke pretenduar se përfundimet e arritura nga Komisioni për konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit nuk bazohen në një hetim të gjithanshëm, të plotë dhe shterues për subjektin e rivlerësimit dhe personat e lidhur me të. Sipas Komisionerit Publik, Kolegji duhet të riçelë hetimin gjyqësor, pasi rezulton se hetimi i Komisionit nuk ka qenë shterues në drejtim të identifikimit të burimeve të ligjshme të krijimit të të ardhurave që kanë shërbyer për krijimin e pasurive të subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur me të. Komisioneri Publik shprehet në ankimin e tij se vlerëson të nevojshme rishikimin e analizës financiare për periudhën e vlerësimit. Referuar ankimit të Komisionerit Publik, ankimi ndaj vendimit të Komisionit nr. 276, datë 21.07.2020, ushtrohet për të tria kriteret e rivlerësimit.
11. Komisioneri Publik kundërshtoi vendimin e Komisionit pasi vlerësoi se, referuar gjendjes së fakteve dhe provave, nuk krijoi bindjen se në rastin objekt shqyrtimi, në analizën e të tria kriterëve të rivlerësimit, gjen zbatim neni 59, pika 1 e ligjit nr. 84/2016. Për rrjedhojë, Komisioneri Publik kërkoi marrjen në shqyrtim të shkaqeve të sipërcituara të ankimit nga ana e Kolegjit dhe në përfundim të gjykimit, në zbatim të nenit 66 të ligjit nr. 84/2016, të vendosë:
 - *Ndryshimin e vendimit nr. 276, datë 21.07.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit; ose:*
 - *Lënien në fuqi të këtij vendimi.*
12. Shkaqet e ankimit për kriterin e vlerësimit të pasurisë, paraqiten në mënyrë të përmbledhur si më poshtë.
 - 12.1. *Lidhur me pasuritë e paluajtshme të llojit “apartament banimi”, me sipërfaqe 95,30 m², si dhe “njësi shërbimi” me sipërfaqe 50 m², me vendndodhje në Gjirokastrë, Komisioneri Publik kundërshtoi konkluzionin e Komisionit si të bazuar në një hetim të paplotë në drejtim të analizës*

financiare të kryer për vitet 2007 dhe 2008. Sipas Komisionerit Publik, në vlerësim të akteve të administruara në fashikullin e çështjes dhe referuar jurisprudencës së Kolegjit, çështjet që kërkojnë hetim të mëtejshëm janë analizimi dhe trajtimi i dy prej burimeve të krijimit të pasurisë së sipërcituar, konkretisht: (i) kursimeve familjare në gjendje *cash* të deklaruara më parë në shumën e 2.300.000 lekëve; dhe (ii) kursimeve në gjendje *cash* të realizuara gjatë vitit 2008 në shumën e 1.100.000 lekëve.

12.2. *Lidhur me shpenzimet për shkollimin e fëmijëve të subjektit të rivlerësimit, në Shqipëri dhe në Mbretërinë e Bashkuar, Komisioneri Publik pretendoi se në analizën e kryer nga Komisioni, këto shpenzime janë llogaritur bazuar vetëm në deklaratimet e subjektit dhe se, sipas tij, nuk rezultoi të jenë administruar akte provuese nga institucionet arsimore lidhur me sa pretendohet në mënyrë deklarative nga subjekti i rivlerësimit për: (i) bursat e përfituara nga këto institucione; (ii) tarifatat e shkollimit, akomodimit; si dhe (iii) shpenzimet e jetesës të kryera nga fëmijët e subjektit të rivlerësimit, znj. Brahimi, brenda dhe jashtë Shqipërisë.*

12.3. *Komisioneri Publik pretendoi se metodologjia e ndjekur nga Komisioni për analizimin e burimeve të ligjshme për periudhën 2014-2016, nuk është e qartë dhe nuk gjen mbështetje në aktet e administruara në dosjen e Komisionit.*

- 13.** Shkaqet e ankimit në lidhje me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale, parashtrohen në mënyrë të përmbledhur si më poshtë.

13.1. Në lidhje me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale, Komisioneri Publik është shprehur se sa i takon transferimit të çështjes civile me palë ndërgjyqëse: paditës A. Ç. e të paditur: Zyra Përmbarrimore “{***}” ShPK dhe me objekt: “Kundërshtim i veprimeve përmbarrimore”, të shqyrtuar në Gjykatën e Apelit Gjyrokastër dhe të përfunduar me vendimin nr. {***}, datë 12.5.2015, në kushtet kur në vendimin e korigjimit nr. 276/1, datë 19.10.2020, si dhe në vendimin nr. 276, datë 21.07.2020, objekt korigjimi, mungon pjesa përshkuese/arsyetuese, ku duhet të pasqyroheshin rrethanat e çështjes civile përkatëse, si dhe arsyet për të cilat është vendosur transferimi i saj për inspektim në organin kompetent, sikurse kërkon pika 4 e nenit 59 të ligjit nr. 84/2016, Komisioneri Publik konstaton pamundësinë e shqyrtimit dhe vlerësimit të këtij konkluzioni të Komisionit dhe për këtë shkak e paraqet këtë çështje në ankim për t’u vlerësuar gjatë shqyrtimit të ankimit në Kolegj.

13.2. Komisioneri Publik u shpreh në ankimin e tij edhe në lidhje me një denoncim të dërguar pranë këtij institucioni më datë 09.10.2020, për të cilin parashtroi se është bërë publik edhe në të paktën një media kombëtare në lajmet e kronikës të datës 25.07.2016. Sipas Komisionerit Publik, ky denoncim i cili lidhet me pretendime dhe dyshime mbi aftësitë profesionale të subjektit të rivlerësimit në vendimmarrjen e një çështjeje penale për të pandehurin H.D., për veprën penale të parashikuar nga neni 290, pika 4 e Kodit Penal, referuar akteve të fashikullit, nuk rezulton që të jetë paraqitur pranë Komisionit dhe, për rrjedhojë, lidhur me këtë denoncim nuk është hetuar prej këtij të fundit. Sipas Komisionerit Publik, në Gjykatën e Lartë rezulton e regjistruar një çështje penale themeli në shqyrtim, me datë regjistrimi 21.01.2019, që i përket: *Rekursuesi* – Prokuroria

e Apelit Gjirokastër, me objekt akuze: Kryerja e veprës penale – “Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor”, neni 290, paragrafi 4 i Kodit Penal”, i pandehur: H.D., me status të çështjes: në studim/shqyrtim.

B. Sipas ankimit të subjektit të rivlerësimit

14. Subjekti i rivlerësimit, znj. Irena Brahimi, në datën 28.10.2020, i është drejtuar Kolegjit me ankim kundër vendimit të Komisionit nr. 276, datë 21.07.2020, që vendosi konfirmimin e saj në detyrë, duke kundërshtuar pjesërisht atë, sa u takon përfundimeve të arritura nga Komisioni në pjesën arsyetuese të tij, si dhe ka integruar brenda përmbajtjes së tij një kundërankim ndaj ankimit të Komisionerit Publik. Shkaqet e ngritura në ankimin e subjektit të rivlerësimit në lidhje me kriterin e vlerësimit të pasurisë, paraqiten në mënyrë të përmbledhur si më poshtë.

14.1. Në lidhje me përfundimet e arritura nga Komisioni në pjesën arsyetuese të vendimit për vlerën e të ardhurave të konsideruara si të ligjshme nga shitja e automjetit me kontratën e datës 19.06.2007, subjekti i rivlerësimit, znj. Irena Brahimi, pretendoi se Komisioni nuk ka arsyetuar në lidhje me shpenzimet e kryera dhe të deklaruara rregullisht prej saj në deklaratën periodike të vitit 2004, për shkak të të cilave, sipas saj, pasuria ka pasur vlerë krijimi në shumën 650.000 lekë dhe jo 421.474 lekë.

14.2. Në lidhje me të ardhurat e përfituara nga dhënia në përdorim e pasurisë “njësi shërbimi” për vitin 2008, në vlerën e 295.000 lekëve, subjekti i rivlerësimit kundërshtoi si të pabazuar në ligj konkluzionin e Komisionit lidhur me moskonsiderimin e këtyre të ardhurave si të ardhura me burim të ligjshëm, me pretendimin se dispozitat e Kodit Civil njohin si formë të disponimit edhe dhënien në përdorim apo dhënien me nënqira të sendit dhe, për rrjedhojë, kërkoi që të ardhurat e deklaruara në deklaratën periodike të vitit 2008, në masën e 295.000 lekëve, për të cilat tatimi është paguar përpara hyrjes në fuqi të ligjit nr. 84/2016, të vlerësohen nga Kolegji si të ardhura të ligjshme.

14.3. Në kuadër të ankimit të paraqitur nga Komisioneri Publik, subjekti i rivlerësimit, znj. Irena Brahimi, u shpreh se paraqet edhe ajo kundërshtimet e saj në drejtim analizës financiare të kryer nga Komisioni, dhe më konkretisht: (i) sa i takon zërit të shpenzimeve të jetesës për vitet 2014, 2015 dhe 2016, i cili, sipas subjektit, është përlllogaritur në mënyrë të gabuar, duke mos marrë në konsideratë përbërjen familjare në këto vite; si dhe (ii) lidhur me përlllogaritjen e gabuar nga Komisioni të të ardhurave nga paga e bashkëshortit të saj nga marrëdhënia e punësimit për vitet 2014-2016.

14.4. Në kundërshtim të shkaqeve të ngritura në ankimin e Komisionerit Publik, subjekti i rivlerësimit parashtrroi se: (i) përlllogaritja në analizën financiare të Komisionit e vitit 2007 e shpenzimeve të jetesës, është kryer në mënyrë të saktë dhe nuk duhet të ndryshojë; dhe se (ii) pretendimet e Komisionerit Publik në lidhje me udhëtimet brenda ditës të bashkëshortit të saj me destinacion qytetin e Janinës, Greqi, si dhe ato në Mbretërinë e Bashkuar janë të pabazuara.

15. Në lidhje me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale, subjekti i rivlerësimit, në kuadër të sa pretenduar nga ana e Komisionerit Publik, në ankimin e ushtruar prej tij lidhur me këtë kriter, parashtroi si më poshtë.

15.1. Në lidhje me çështjen gjyqësore për të cilën Komisioni ka vendosur transferimin e saj pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, subjekti i rivlerësimit u shpreh se u qëndron shpjegimeve të dhëna në parashtrimet e saj rreth raportit të rezultateve të hetimit në Komision.

15.2. Ndërsa, sa i takon denoncimit të referuar në ankim nga Komisioneri Publik, subjekti i rivlerësimit, znj. Irena Brahimi, u shpreh se Kolegji dhe Komisioneri Publik do të njihen në këtë gjykim me vendimin penal dhe arsyetimin e plotë që e bazon atë vendim. Sipas saj, vendimarrja e Gjykatës së Apelit lidhur me këtë çështje u referohet tri provave shkencore të administruara gjatë gjykimit në shkallë të parë, të cilët kanë arritur në të njëjtin përfundim, se veprimet e të pandehurit H. D. nuk kanë qenë shkak determinant për ndodhjen e aksidentit.

16. Ankimin e saj para Kolegjit, subjekti i rivlerësimit, znj. Irena Brahimi, e shoqëroi me disa akte shkresore. Në përfundim, subjekti i rivlerësimit, kërkoi: *Lënien në fuqi të vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 276, datë 21.07.2020, sa i takon disponimit në pikën 1 të tij për konfirmimin në detyrë, duke ndryshuar ndërkohë arsyetimin dhe konsideruar si të ligjshme të ardhurat nga shitja e automjetit në vitin 2007, si dhe të ardhurat nga dhënia në përdorim e sendit “njësi” në vitin 2008.*

IV. Vlerësimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

A. Mbi aspektet procedurale të gjykimit

a) Juridiksioni i Kolegjit

17. Në përputhje me nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenin F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, Kolegji ka juridiksion (*ratione materiae*) ndaj ankimeve kundër vendimeve të Komisionit lidhur me rivlerësimin e subjekteve, të parashikuar nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4 të Kushtetutës, përveç rasteve të vendimeve të dhëna sipas nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim, për sa kohë ka për objekt kundërshtimin e një vendimi të Komisionit, i cili ka vendosur për rivlerësimin e subjektit të rivlerësimit, znj. Irena Brahimi, duke e konfirmuar atë në detyrë, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit, i cili merr në shqyrtim ankimet ndaj vendimeve të Komisionit, sipas rregullave të përcaktuara në nenin 65 të ligjit nr. 84/2016.

b) Legjitimimi i Komisionerit Publik si ankues

18. Komisioneri Publik legjitimohet *ratione personae* në kuptim të nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neneve C, pika 2 dhe F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, dhe *ratione temporis* pasi ankimi është depozituar pranë Komisionit brenda afatit ligjor prej 15

ditësh⁵ nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016.

c) *Legjitimimi i subjektit të rivlerësimit si ankues*

19. Subjekti i rivlerësimit legjitimohet *ratione personae* në kuptim të nenit 179/b, pika 4 e Kushtetutës, nenit F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 dhe *ratione temporis* pasi ankimi është depozituar pranë Komisionit brenda afatit ligjor prej 15 ditësh⁶ nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016.

ç) *Forma dhe mënyra e shqyrtimit të ankimit*

20. Në përputhje me nenin 65, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, shqyrtimi i ankimit në rastin kur vendimi i Komisionit ankimohet nga Komisioneri Publik, kryhet në seancë gjyqësore publike. Për rrjedhojë, edhe çështja objekt gjykimi, e cila lidhet me shqyrtimin e ankimit të Komisionerit Publik ndaj vendimit të Komisionit nr. 276, datë 21.07.2020, për subjektin e rivlerësimit, znj. Irena Brahimi, si dhe të ankimit të vetë subjektit të rivlerësimit, ndaj të njëjtit vendim të Komisionit, në përputhje me parashikimin e nenit 448 të Kodit të Procedurës Civile dhe nenit 4, pika 6 e ligjit nr. 84/2016, u mor në shqyrtim nga Kolegji në seanca gjyqësore publike, të zhvilluara në prani të palëve.
21. Në vijim të kërkesës së Komisionerit Publik për riçeljen e hetimit gjyqësor, si dhe rishikimin e zërave të analizës financiare të Komisionit, sipas pretendimeve të paraqitura në ankimin e tij dhe gjatë parashtrësive në Kolegj, si dhe të kërkesës së subjektit të rivlerësimit drejtuar trupit gjykues për riçeljen e hetimit gjyqësor dhe administrimin si provë shkresore të akteve të depozituara gjatë parashtrimeve në Kolegj, trupi gjykues, pasi dëgjoji shpjegimet e palëve, në funksion të shqyrtimit të çështjes, me vendim të ndërmjetëm⁷, bazuar në nenin F, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, vendosi:

⁵ Siç rezultoi nga aktet e administruara në fashikullin gjyqësor, vendimi i Komisionit nr. 276, datë 21.07.2020, për rivlerësimin e subjektit, znj. Irena Brahimi, i është njoftuar Institucionit të Komisionerit Publik, më datë 08.10.2020, me shkresën nr. {***} prot., të së njëjtës datë, konfirmuar sipas lajmërimarrjes së nënshkruar nga J. Z., kurse ankimi i Komisionerit Publik është depozituar pranë Komisionit me shkresën nr. {***} prot., datë 23.10.2020, protokolluar në Komision me nr. {***} prot., datë 23.10.2020, që rezulton të jetë dita e 15-të e afatit ligjor për të ushtruar ankim në përputhje me nenin 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016.

⁶ Siç rezultoi nga aktet e administruara në fashikullin gjyqësor, vendimi i Komisionit nr. 276, datë 21.07.2020, për rivlerësimin e subjektit, znj. Irena Brahimi, i është njoftuar kësaj të fundit më datë 08.10.2020, me shkresën nr. {***} prot., të së njëjtës datë, konfirmuar sipas lajmërimarrjes së datës 09.10.2020, kurse ankimi i subjektit të rivlerësimit është depozituar pranë shërbimit postar më datë 26.10.2020, konfirmuar sipas “formularit shoqërues të dërgesës nr. {***}”, që rezulton të jetë dita e fundit e afatit ligjor për të ushtruar ankim në përputhje me nenin 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016.

⁷ Shih procesverbalet e seancës gjyqësore të datës 11.05.2023 dhe të datës 05.06.2023.

- (i) çeljen e hetimit gjyqësor, duke marrë në cilësinë e provës aktet e individualizuara nga subjekti i rivlerësimit në seancën gjyqësore të datës 11.05.2023 dhe të datës 05.06.2023;
 - (ii) kryerjen e një analize financiare paraprake lidhur me pretendimet në ankim dhe në parashtrime të Komisionerit Publik dhe të subjektit të rivlerësimit në Kolegj, si dhe njoftimin e saj palëve në proces;
 - (iii) pranimin e kërkesës së Komisionerit Publik që në funksion të hetimit gjyqësor t'i kërkohet Gjykatës së Lartë fashikulli i çështjes penale me nr. 83/2019, që i përket rekursit të Prokurorisë së Apelit Gjirokastër për çështjen penale me të pandehur H. D., në kuadër të një denoncimi të depozituar në institucionin e Komisionerëve Publikë.
22. Në zbatim të vendimit të mësipërm të trupit gjykues, analiza financiare paraprake për subjektin e rivlerësimit, znj. Irena Brahimi, e përgatitur nga Njësia e Shërbimit Ligjor, si dhe fashikulli i çështjes penale të sipërcituar, të administruar nga Gjykata e Lartë, iu përcollën Komisionerit Publik dhe subjektit të rivlerësimit, duke iu dhënë atyre mundësinë të njiheshin dhe t'i debatnin ato në seancë gjyqësore publike. Subjekti i rivlerësimit, në funksion të analizës paraprake, kërkoi marrjen e disa provave të tjera shkresore, të cilat, pasi u pranuan për shqyrtim nga trupi gjykues, u debatuan nga palët në seancë gjyqësore.
- B. Vlerësimi i shkaqeve të ankimit lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë, në aspektin e konstatimit të drejtë të situatës faktike dhe zbatimit të ligjit material*
23. Lidhur me pasuritë e paluajtshme të llojit “apartament banimi” me sipërfaqe 95,30 m² dhe “njësi shërbimi” me sipërfaqe 50 m², me vendndodhje në Gjirokastër, për të cilat Komisioneri Publik pretendoi se hetimi i Komisionit për verifikimin e mjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme për krijimin e këtyre pasurive është i paplotë, trupi gjykues konstatoi sa më poshtë.
24. Komisioni, në kontrollin dhe vlerësimin e këtyre dy pasurive gjatë procesit të rivlerësimit, ka arsyetuar në vendim: *Në konkluzion të vlerësimit të këtyre pasurive, duke marrë në konsideratë të gjitha të dhënat dhe vlerësimet e përshkruara në pikat e mësipërme, Komisioni ka përllogaritur mundësitë financiare të subjektit të rivlerësimit për të gjitha pagesat e kryera për blerjen e pasurive apartament dhe njësi shërbimi, gjatë vitit 2008, nga ku ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit ka pasur një mungesë të burimeve të ligjshme financiare, në vlerën prej -288.987 lekësh, siç është përshkruar edhe në tabelën në vijim. Këtë konkluzion, për mungesë të burimeve të ligjshme lidhur me krijimin e këtyre dy pasurive objekt kontrolli, Komisioni e ka çmuar së bashku me konkluzionet e arritura për pasuritë e tjera të subjektit të rivlerësimit dhe të personave të lidhur me të, duke arritur në përfundimin se në vlerësimin tërësor të kriterit të pasurisë, pasaktësitë e konstatuara në deklarime dhe mungesa e burimeve të ligjshme financiare, vlerësuar sipas parimit të objektivitetit dhe proporcionalitetit, nuk justifikon dhënien e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra, bazuar në parashikimet e nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.*
25. Komisioneri Publik e kundërshtoi si të pabazuar konkluzionin e Komisionit lidhur me pasuritë objekt kontrolli, me pretendimin se hetimi administrativ ka qenë i paplotë në drejtim të analizës

financiare të kryer për vitet 2007 dhe 2008. Sipas Komisionerit Publik, në vlerësim të akteve të administruara në fashikullin e çështjes dhe referuar jurisprudencës së Kolegjit, çështjet që kërkojnë hetim të mëtejshëm janë analizimi dhe trajtimi: (i) i kursimeve familjare në gjendje *cash*, të deklaruara në shumën e 2.300.000 lekëve; dhe (ii) i kursimeve në gjendje *cash*, të realizuara gjatë vitit 2008, në shumën e 1.100.000 lekëve, të cilat janë deklaruar nga subjekti i rivlerësimit si burim krijimi për pasuritë: “Apartament banimi me sip. 95,30 m²” dhe “Njësi shërbimi me sip. 50 m²”. Këtë shkak të ankimit të tij, Komisioneri Publik e mbështeti në pretendimet dhe argumentet e mëposhtme.

25.1. Komisioneri Publik pretendoi se metodologjia e ndjekur nga Komisioni për analizimin e mundësisë financiare të subjektit të rivlerësimit për krijimin e kursimeve *cash* për periudhën 2006-2007, nuk gjen mbështetje në jurisprudencën e deritanishme të Kolegjit pasi:

- (i) për të ardhurat nga punësimi i personit të lidhur A. B., pranë laboratorit privat “{***}”, për vitet 2006 dhe 2007, është administruar vetëm një akt shkresor i thjeshtë nga punëdhënësi i pretenduar dhe subjektit të rivlerësimit nuk i është kërkuar të provojë ligjshmërinë e këtyre të ardhurave;
- (ii) për shpenzimet e jetesës për vitin 2007, llogaritjet e kryera nga Komisioni nuk janë bazuar në informacionin e dërguar nga ILDKPKI/INSTAT, por janë rezultat i një mesatareje të shpenzimeve të vitit 2006 dhe 2008;
- (iii) për shpenzimet e udhëtimit të kryera nga anëtarët e familjes Brahimi, vlerësohet e nevojshme rillogaritja e tyre duke u bazuar në aktet e administruara në dosjen e Komisionit.

25.2. Ndërsa në lidhje me analizën e kryer për verifikimin e ligjshmërisë së kursimeve të realizuara gjatë vitit 2008, në vlerën e 1.100.000 lekëve, Komisioneri Publik pretendoi se metodologjia e ndjekur nga Komisioni për llogaritjen e shpenzimeve të udhëtimeve të kryera nga anëtarët e familjes Brahimi, nuk mbështetet në jurisprudencën e Kolegjit.

- 26.** Bazuar në sa më sipër, Komisioneri Publik kërkoi rivlerësimin nga Kolegji të zërave respektivë të analizës financiare të Komisionit, në funksion të kontrollit të ligjshmërisë së burimeve të krijimit të pasurive të sipërcituara, objekt kontrolli sipas këtij shkakut ankimi.
- 27.** Në kundërshtim të shkakut të ankimit të Komisionerit Publik për hetim të mëtejshëm në drejtim të analizës financiare të kryer për vitet 2007 dhe 2008, sa i takon pretendimit të këtij të fundit për përlllogaritje të gabuar të shpenzimeve të jetesës për vitin 2007, subjekti i rivlerësimit, znj. Irena Brahimi u shpreh se mbështet analizën financiare të Komisionit dhe pretendoi se një llogaritje ndryshe e këtyre shpenzimeve, sipas pretendimit të Komisionerit Publik, nuk do të përkonte me realitetin dhe do të krijonte një disbalancë të pajustificuar brenda tri viteve të njëpasnjëshme (2006, 2007 dhe 2008), ndërkohë që, sipas saj, treguesit e familjes dhe nevojat e jetesës kanë qenë të pandryshuara.
- 28.** Gjithashtu, gjatë gjykimit në Kolegji, subjekti i rivlerësimit, sa i takon ligjshmërisë së të ardhurave të deklaruara nga marrëdhënia e punësimit të bashkëshortit me laboratorin privat “{***}”, në Gjyrokastër, për periudhën 2006-2016, pasi dorëzoi në cilësinë e provës disa akte shkresore, të cilat

u pranuan nga trupi gjykues, pretendoi se, sipas tyre, provohet jo vetëm marrëdhënia e punës së bashkëshortit A. B. me laboratorin “{***}”, në funksionin e drejtuesit teknik, por edhe pagesa mujore për punën e tij në këtë funksion, për periudhën e sipërcituar 2006-2016. Në konkluzionet përfundimtare para Kolegjit, subjekti i rivlerësimit kërkoi që, në raport me parashikimin e nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, për vitet objekt kontrolli, 2006 dhe 2007, të vlerësohen si të ardhura të ligjshme, të ardhurat nga punësimi, të përjashtuara nga tatimi mbi të ardhurat, sipas parashikimit të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar.

29. Lidhur me pasuritë objekt kontrolli, subjekti i rivlerësimit, znj. Irena Brahimi, nëpërmjet ankimit të saj, kundërshtoi përfundimet e arritura nga ana e Komisionit në pjesën arsyetuese të vendimit sa i takon: (a) vlerës së të ardhurave të konsideruara si të ligjshme nga shitja e automjetit me kontratën e datës 19.06.2007, për të cilat subjekti pretendoi se Komisioni nuk ka arsyetuar në lidhje me shpenzimet e kryera dhe të deklaruara rregullisht prej saj në deklaratën periodike të vitit 2004, për shkak të të cilave, sipas saj, pasuria (automjet) ka pasur vlerë krijimi shumë më 650.000 lekë dhe jo 421.474 lekë; dhe (b) të ardhurave të përfituara nga dhënia në përdorim e pasurisë “njësi shërbimi” për vitin 2008, në vlerën e 295.000 lekëve, duke e kundërshtuar si të pabazuar në ligj konkluzionin e Komisionit lidhur me moskonsiderimin e këtyre të ardhurave si të ardhura me burim të ligjshëm.
30. Në mbështetje të sa më sipër, sa u takon të ardhurave të pretenduara nga shitja e automjetit, subjekti i rivlerësimit pretendoi se me blerjen e automjetit me targa të huaja, përveç kostove të zhdoganimit, duhej të paguheshin edhe tarifatat përkatëse administrative, për të mundësuar qarkullimin e automjetit në territorin e Republikës së Shqipërisë, po ashtu edhe pagesa e siguracionit. Gjithashtu, sipas subjektit, një automjet që blihet i përdorur, ka nevojë për shërbime shtesë (ndërrim të gomave, amortizatorëve, frenave, vajit filtrave, etj.), me qëllim garantimin e sigurisë së qarkullimit në rrugë. Subjekti pretendoi se në këtë kontekst, referuar edhe parashikimit të nenit 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, deklarimet periodike duhet të ishin vlerësuar si provë në lidhje me shpenzimet e kryera, si dhe sa u takon rrethanave të faktit në lidhje me servisin. Për rrjedhojë, subjekti i rivlerësimit kërkoi nga ana e Kolegjit të vlerësojë si të ardhur të ligjshme nga shitja, shumë prej 650.000 lekësh, e cila në momentin e blerjes së automjetit ka përbërë shpenzim dhe, për rrjedhojë, nuk mund të konsiderohej fitim pas shitjes së automjetit për t’iu nënshtruar tatimit, sipas ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”.
31. Ndërsa, sa u takon të ardhurave të deklaruara si të krijuara nga dhënia në përdorim e pasurisë “njësi shërbimi” për vitin 2008, në vlerën e 295.000 lekëve, subjekti i rivlerësimit pretendoi se dispozitat e Kodit Civil njohin si formë të disponimit edhe dhënien në përdorim apo dhënien me nënqira të sendit dhe se referuar nenit 305 të Kodit Civil, posedimi mbi një send është i ligjshëm kur poseduesi e ka posedimin nga pronari në bazë të një veprimi juridik, në bazë të ligjit apo një akti administrativ. Në kontekst të sa më sipër, subjekti argumentoi se mes palëve ka ekzistuar që prej muajit janar të vitit 2008, një marrëveshje për shitjen në të ardhmen të sendit, e garantuar kjo marrëveshje me pagimin e një kapari prej 1.000.000 lekësh, dhe se në deklaratën noteriale përkatëse, administratori ka konfirmuar faktin se shoqëria ka dhënë pëlqimin që sendi të jepet në përdorim.

32. Në lidhje me provueshmërinë e marrëdhënies me {***}, subjekti pretendoi pamundësi objektive për të sjellë dokumentacion justifikues, duke qenë se ky institucion është mbyllur nga Ministria e Arsimit në vitin 2014. Në këtë kuadër, subjekti i rivlerësimit kërkoi që të ardhurat e deklaruara në DIPPV-në e vitit 2008, në masën e 295.000 lekëve, për të cilat tatimi është paguar përpara hyrjes në fuqi të ligjit nr. 84/2016, të vlerësohen nga Kolegji si të ardhura të ligjshme.
33. Në kuadër të shqyrtimit të shkaqeve të ngritura në ankimet e Komisionerit Publik dhe subjektit të rivlerësimit lidhur me krijimin në vitin 2008, të dy pasurive të paluajtshme objekt kontrolli, nga shqyrtimi i akteve të fashikullit të krijuar gjatë hetimit të kryer në Komision dhe hetimit gjyqësor në Kolegj, si dhe pasi çmoi të gjitha pretendimet e palëve të parashtruara gjatë seancave gjyqësore publike, trupi gjykues konstatoi dhe vlerësoi si më poshtë.
- ° *Lidhur me të ardhurat nga punësimi i personit të lidhur A. B., pranë laboratorit privat “{***}”, për vitet 2006 dhe 2007*
34. Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në deklaratën e pasurisë *vetting*, të ardhura të bashkëshortit A. B. si mjek mikrobiolog, drejtues teknik pranë laboratorit “{***}”, Gjirokastër, në janar 2006 - dhjetor 2016, vlerën totale prej 5.400.000 lekësh. Në kuadër të detyrimit ligjor të përcaktuar nga neni 32, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, për të justifikuar vërtetësinë e deklarimeve të kryera në lidhje me ligjshmërinë e burimeve të të ardhurave të deklaruara, subjekti i rivlerësimit, së bashku me deklaratën e pasurisë *vetting*, ka dorëzuar edhe një vërtetim të lëshuar më datë 13.10.2016, nga znj. I. Z., në cilësinë e administratores së klinikës “{***}”, me anë të të cilit vërteton: *Z. A. B. ka ofruar shërbimin si mjek mikrobiolog pranë kësaj klinike dhe në periudhën 2006-2016 (janar – tetor), ka realizuar të ardhura neto si më poshtë: [...]. Sipas këtij vërtetimi, të ardhurat e krijuara janë deklaruar për çdo vit të periudhës së deklaruar të punësimit, nga ku rezultoi se për vitet objekt kontrolli, 2006 dhe 2007, të ardhurat e realizuara nga z. A. B. janë nga 360.000 lekë për secilin vit.*
35. Trupi gjykues vëren se gjatë procedurës së kontrollit të ushtruar nga ILDKPKI-ja dhe në vijim nga Komisioni, në kuadër të verifikimit të të ardhurave të deklaruara nga punësimi i bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit pranë klinikës “{***}”, janë administruar disa akte shkresore, sipas të cilave e vetmja shkresë që shprehet në lidhje me punësimin e bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit në periudhën më të afërt me periudhën objekt kontrolli, është shkresa e Sektorit të Kontrollit Tatimor të Drejtorisë Rajonale Tatimore Gjirokastër⁸, në të cilën referohet: *Në vijim të shkresës së ardhur nga sektori i shërbimit dhe regjistrimit të tatimpaguesit me nr. [...], ju informojmë si më poshtë: Nga verifikimi i bërë në sistemin tatimor E-c@ts rezultoi se: [...] A. B. nuk rezulton i regjistruar si tatimpagues. [...] nga verifikimi i bërë në zyrën e kontabilitetit, rezultuan pagesa tatimi në burim për shtetasin A. B., si më poshtë: 1. Për shtetasin A. B. nga subjekti I. Z. është paguar tatim mbi të ardhurat për periudhën 2008-2012, në shumën 300.000*

⁸ Referuar shkresës me nr. {***} prot., datë 21.7.2017.

lekë. 2. A. B. ka derdhur tatim mbi të ardhurat e realizuara pranë klinikës “{***}” për vitin 2013, në shumën 60.000 lekë. 3. [...].

36. Nga shqyrtimi i të gjitha akteve të administruara në kuadër të hetimit të kësaj çështjeje, me burim informacioni organin përgjegjës tatimor, trupi gjykues konstatoi se për periudhën e viteve 2006-2007, objekt kontrolli, nuk është administruar asnjë e dhënë zyrtare në lidhje me marrëdhënien e punësimit/bashkëpunimit të pretenduar mes z. A. B. dhe klinikës “{***}”, të përfaqësuar nga znj. I. Z.. Gjurma më e hershme në aktet e fashikullit të Komisionit në lidhje me punësimin e bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit pranë kësaj klinike, konfirmohet nga komunikimi i sipërcituar në vitin 2008⁹.
37. Trupi gjykues konstatoi se referuar hetimit administrativ të kryer në Komision, të ardhurat e deklaruara si të krijuara nga punësimi i bashkëshortit të subjektit pranë klinikës “{***}” për vitet 2006 dhe 2007, nuk provohen me asnjë dokumentacion, përveç vërtetimit të sipërpërmendur të lëshuar nga znj. I. Z., më datë 13.10.2016. Subjekti i rivlerësimit gjithashtu nuk rezultoi të ketë dorëzuar asnjë akt justifikues/provues të fakteve të pretenduara, përveç vërtetimit të punëdhënësit si më sipër referuar, si dhe një vërtetimi të punëdhënësit të datës 21.02.2007, i nëshkruar nga z. P. Q., në cilësinë e presidentit të laboratorit “{***}” ShPK, në të cilin thuhet se: *mjeku A. B. është punonjës në laboratorin “{***}” ShPK, prej vitit janar-dhjetor 2006, me pagesë prej 30.000 lekësh të reja. Pavarësisht sa më sipër, trupi gjykues vëren se nga ana e Komisionit, subjektit të rivlerësimit nuk i është kaluar asnjë barrë prove lidhur me ligjshmërinë e këtyre të ardhurave, duke i përfshirë ato në analizën financiare në masën e pretenduar nga subjekti i rivlerësimit.*
38. Gjatë gjykimit të zhvilluar në Kolegj, subjekti i rivlerësimit lidhur me këtë çështje, depozitoi një sërë aktesh shkresore, të cilat, në vlerësim të trupit gjykues, provojnë faktin e ekzistencës së marrëdhënies së bashkëshortit të saj, z. A. B., si drejtues teknik i laboratorit mjekësor “{***}”, në periudhën kohore 2006 – 2007, referuar licencave të lëshuara nga Ministria e Shëndetësisë, respektivisht nr. {***}, datë 10.05.2006 dhe nr. {***}, datë 28.05.2008, por që nuk arritën të provojnë marrëdhënien financiare që ka ekzistuar mes palëve në lidhje me këtë marrëdhënie bashkëpunimi. Trupi gjykues mbajti në konsideratë gjithashtu që lidhur me këtë marrëdhënie, jo vetëm gjatë hetimit administrativ, por edhe gjatë gjykimit në Kolegj, ku u debatua në seancë publike kjo çështje, nuk u depozitua nga subjekti i rivlerësimit asnjë dokumentacion justifikues në formën e aktit shkresor, që të përcaktonte natyrën e punës/bashkëpunimit mes bashkëshortit të saj dhe laboratorit mjekësor, të drejtat dhe detyrimet e palëve të përfshira, vlerën e kundërshtëpërblimit/pagesës, si dhe mënyrën e afatet e përfitimit të saj nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit. Për më tepër, edhe nga verifikimi i kryer akteve të fashikullit, nuk rezultoi asnjë e dhënë në drejtim të përfitimit të këtyre pagesave të pretenduara, as nëpërmjet sistemit bankar (referuar këtu verifikimit të llogarive bankare të z. A. B.), as në ndonjë formë tjetër, sikundër dhe nuk u provuan këto të ardhura as nëpërmjet të dhënave lidhur me deklarinimin e tyre pranë organeve shtetërore përgjegjëse dhe përmbushjes së detyrimeve tatimore përkatëse. Për rrjedhojë të sa më

⁹ Shih paragrafin 35 më sipër në këtë vendim.

sipër, trupi gjykues, referuar edhe jurisprudencës së tij të konsoliduar në lidhje me shqyrtimin e pretendimeve për çështje të ngjashme, arriti në përfundimin se të ardhurat e deklaruara si të përfituara nga punësimi i bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit si drejtues teknik pranë laboratorit mjekësor “{***}”, për periudhën e viteve 2006-2007, nuk përmbushin standardin kushtetues të të ardhurave të ligjshme, sipas përcaktimit të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës. Pretendimi i subjektit të rivlerësimit për konsiderimin si të ardhura të ligjshme të të ardhurave nga punësimi, të përjashtuara nga tatimi, sipas parashikimit ligjor të kohës, u çmua nga trupi gjykues si pretendim i pabazuar në fakte, për sa kohë nuk u provua në asnjë formë fakti i përfitimit real të të ardhurave nga marrëdhënia e krijuar me laboratorin mjekësor “{***}”.

39. Në këto kushte, trupi gjykues e gjeti të drejtë dhe të bazuar pretendimin e Komisionerit Publik se konkluzioni i Komisionit në drejtim të vlerësimit të ligjshmërisë së të ardhurave objekt kontrolli, është i pabazuar në fakte dhe në ligj. Për këtë arsye, këto të ardhura nuk duhet të ishin përfshirë në zërin e të hyrave/të ardhurave në analizën finaciare të kryer nga Komisioni në kuadër të verifikimit të mjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme për krijimin e dy pasurive të paluajtshme objekt kontrolli, sipas këtij shkak ankimi.

◦ *Lidhur me të ardhurat e deklaruara si të krijuara nga shitja e automjetit “Mercedes Benz” 124 D, në vitin 2007*

40. Sa i takon pretendimit të subjektit të rivlerësimit në lidhje me vlerësimin që u ka bërë Komisioni të ardhurave të deklaruara si të krijuara nga shitja e automjetit “Mercedes Benz” 124 D, në vitin 2007, trupi gjykues, pasi shqyrtoi dokumentacionin e fashikullit lidhur me këtë pasuri objekt kontrolli, konstatoi si më poshtë.
41. Në datën 14.05.2004, nëpërmjet kontratës së shitblerjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., të lidhur në prani të noterit A. A., bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, z. A. B., ka blerë një automjet të tipit “Mercedes Benz” 124 D, përkundrejt çmimit 250.000 lekë. Në deklaratën periodike pranë ILDKPKI-së të vitit 2004, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në rubrikën e “Pasurive të paluajtshme dhe të luajtshme”, blerjen e *autoveturës tip “Benz Mercedes”*, në vlerën e 650.000 lekëve.
42. E pyetur në lidhje me deklarimin e çmimit të blerjes së automjetit në deklaratën periodike të vitit 2004, subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të pyetjes nr. 3 të pyetësorit nr. 6 të Komisionit, është shprehur: *Në lidhje me shumën e krijimit të pasurisë 650.000 lekë, deklaruar prej meje në deklarimin periodik të vitit 2004, sqaroj se, përveç çmimit të blerjes së automjetit në shumën 250.000 (dyqind e pesëdhjetë mijë) lekë, është paguar nga ana e bashkëshortit vlera prej 171.474 (njëqind e shtatëdhjetë e një mijë e katërqind e shtatëdhjetë e katër) lekësh për zhdoganimin e makinës, pasi sikurse rezultoi dhe nga kontrata, automjeti ka qenë me targa të huaja [...]. Po ashtu, sikurse më deklaroi im shoq, ai ka paguar shpenzimet administrative për targimin e mjetit, leje qarkullimi dhe siguracionin përkatës, si dhe i ka paguar shitësit, sipas kërkesës së këtij të fundit, shpenzimet për transportin e makinës, pasi automjeti është sjellë nga Holanda. Bashkëshorti më deklaroi gjithashtu se në momentin e blerjes, duke qenë se automjeti nuk ka qenë*

i ri, ka shpenzuar rreth 100.000 lekë për një servis tërësor (goma, amortizator, vaj, filtra, frena etj). [...] Pra, tej çmimit të blerjes që parashikon kontrata, janë kryer dhe pagesa të tjera për krijimin e pasurisë së llojit automjet, në përlllogaritje të të cilave më ka rezultuar vlera e deklaruar në deklaratën e vitit 2004.

43. Në datën 19.06.2007, para noterit B. A. A. është lidhur një kontratë shitjeje automjeti me nr. {***} rep., dhe nr. {***} kol., me anë të së cilës, bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, z. A. B., ka shitur automjetin e tipit “Mercedes Benz” 124 D, kundrejt vlerës së 760.000 lekëve. Në kontratë vihet re parashikimi si vijon: *Noteri orienton palën shitëse për pagesën e 2% të çmimit të shitjes në favor të shtetit, pagesë e cila bëhet në Drejtorinë Rajonale të Shërbimit të Transportit Rrugor të rrethit përkatës.*
44. Në deklaratën e pasurisë *vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *Të ardhura nga shitja e automjetit me kontratën {***} rep., {***} kol., datë 19.06.2007, 760.000 lekë, tatim në masën 2% sipas kontratës, neto 744.800 lekë.*
45. Subjekti i rivlerësimit, znj. Irena Brahim, në shpjegimet e saj ndaj rezultateve të hetimit, sipas të cilave i ka kaluar barra e provës për të provuar ligjshmërinë e të ardhurave të krijuara nga shitja e automjetit, është shprehur lidhur me këto të ardhura, ndër të tjera, si vijon: *Në analizë të burimeve financiare si më sipër, konstatoj se, në raportin tuaj keni konkluduar për një mungesë burimesh të ligjshme financiare për vitin 2007, në shumën minus 237.127 lekë, që sipas jush, ndikon edhe në shumën e kursimeve të deklaruara si gjendje cash prej 2.300.000 lekësh, për periudhën 2005-2007. Kjo arsyetoni ju, ka ardhur si rrjedhojë e të ardhurave të fituara nga shitja e automjetit me targë {***}. Në lidhje me këtë automjet, keni vlerësuar se është blerë kundrejt çmimit 421.474 lekë dhe është shitur kundrejt çmimit 760.000 lekë. Diferencën ndërkohë nuk e konsideroni si të ardhur të ligjshme, pasi nuk është paguar tatim mbi të ardhurat. Në lidhje me këtë pikë, bëj me dije se automjeti {***} është shitur me kontratën e shitblerjes nr. {***} rep., {***} kol., datë 19.06.2007, në shumën 760.000 lekë, shtetasit F. C.. Në kontratë thuhet shprehimisht se “noteri orienton palën shitëse për pagesën e 2% çmimit të shitjes në favor të shtetit” dhe unë ju kam dorëzuar mandatin e rregullt të pagesës. Bashkëshorti ka vlerësuar se ky ishte tatimi për t’u paguar në atë kohë. Gjithsesi, duke marrë parasysh konstatimet tuaja, bashkëshorti ka deklaruar pranë DR Tatimore Gjirokastër, shumën e cilësuar nga ju si e ardhur e paligjshme dhe me urdhërpagesën dhe mandatarkëtimin, datë 03.07.2020, ka paguar tatimin mbi të ardhurat për shumën 338.526 lekë, në vlerën 33.853 lekë. Mandatin kërkoj ta administroj në cilësinë e provës shkresore, duke cilësuar si të ligjshme të ardhurën e krijuar nga shitja e automjetit dhe këtu i referohem edhe praktikës suaj, mbajtur për raste të ngjashme.*
46. Në përfundim të kontrollit të ushtruar lidhur me krijimin e pasurisë së luajtshme të llojit “automjet”, të tipit “Mercedes-Benz” Daimler Chrysler C 220 CDI, me vit prodhimi 2000, të blerë në vitin 2007, me burim krijimi të deklaruar në deklaratën e pasurisë *vetting*, ndër të tjera edhe të ardhurat e krijuara nga shitja e automjetit të mëparshëm të tipit “Mercedes Benz”, vit prodhimi 1992, Komisioni ka arsyetuar në vendim si vijon: *Lidhur me fitimin e realizuar nga kjo shitje, për*

të cilën subjekti i rivlerësimit nuk ka paguar detyrimin tatimor përkatës, referuar ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, ka qenë detyrimi i subjektit të rivlerësimit të paguante tatimin mbi të ardhurat e përfituara. [...] Për sa më sipër, nëpërmjet përlllogaritjeve të kryera përgjatë dhe në konkluzion të hetimit administrativ, fitimi i realizuar prej 338.526 lekësh, si diferencë e çmimit të shitjes prej 760.000 lekësh dhe çmimit të blerjes (250.000 lekë + 171.474 lekë tarifa e zhdoganimit), në përputhje me parashikimet ligjore, nuk janë konsideruar si të ardhura me burim të ligjshëm, për sa kohë nuk janë paguar detyrimet tatimore. [...] Lidhur me tatimin e paguar nga bashkëshorti i subjektit, në datën 3.7.2020, në shumën prej 33.853 lekësh (me përshkrimin: tatim për kalimin e së drejtës së pronësisë), Komisioni vlerëson se nuk mund të merret në konsideratë dhe nuk mund të legjitimohet, post Vetting, të ardhura për të cilat nuk janë paguar detyrimet tatimore më herët. Për sa më lart konkludohet, duke pasur në vëmendje edhe qëndrimin e konsoliduar të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit¹⁰, sipas të cilit: "[...] pagesa e detyrimeve tatimore pas deklaratës "vetting" në janar të vitit 2017 është e papranueshme dhe nuk e shmang subjektin nga përgjegjësia ligjore, pasi nuk mund të zhbëjë qasjen e subjektit të rivlerësimit në kundërshtim me ligjin ndër vite, që u karakterizua nga mospagimi i detyrimeve tatimore në momentin dhe vitin përkatës kur ato duhej të shlyheshin [...].

47. Në kuadër të shqyrtimit të pretendimit të subjektit të rivlerësimit për konsiderimin përfundimisht¹¹ si të ardhura të ligjshme të të ardhurave të krijuara nga shitja e automjetit në vitin 2007, në shumën e çmimit të shitjes prej 760.000 lekësh dhe, për rrjedhojë, përfshirjen si të ardhur të ligjshme të kësaj shume në analizën financiare të këtij viti, trupi gjykues, në vlerësim të sa më sipër evidentuar, çmoi se ky pretendim është i drejtë dhe i bazuar. Shlyerja nga ana e bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit e detyrimin të përcaktuar sipas ligjit nr. 8977, datë 12.12.2002, "Për sistemin e taksave në Republikën e Shqipërisë", për pagesën e vlerës prej 2% të çmimit të shitjes së automjetit si taksë kombëtare në rastin e kalimit të së drejtës së pronësisë së tij nga shitësi të blerësi, referuar edhe në kontratën e shitblerjes dhe provuar sipas "mandat arkëtimit nr. {***}, datë 25.06.2007", lëshuar në kuadër të faturës së shërbimit nr. {***}, datë 25.06.2007 [për taksën e kalimit të së drejtës së pronësisë për pasurinë e paluajtshme (automjeti)], u mbajt në konsideratë nga ana e trupit gjykues në drejtim të vlerësimit mbi përmbushjen e standardit të ligjshmërisë së të ardhurave, të përcaktuar në nenin D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, sa u takon të ardhurave të krijuara nga shitja e automjetit në vitin 2007, në vlerën e 760.000 lekëve, duke qenë se ky ka qenë i vetmi përcaktim ligjor i shprehur, në përputhje dhe me parashikimin e nenit 155 të Kushtetutës¹² për vendosjen e një detyrimi të natyrës fiskale lidhur me këto lloj transaksionesh. Për rrjedhojë, pagesa e kryer pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Gjirokastër, referuar mandatarkëtimit të datës 03.07.2020, nuk çmohet nga ana e trupit gjykues si një tentativë për të legjitimuar *post factum* një

¹⁰ Komisioni i është referuar vendimit të Kolegjit nr. 5/2020, f. 23, pika 41.9.

¹¹ Referuar këtu qëndrimin të mbajtur në konkluzionet përfundimtare para Kolegjit gjatë seancës gjyqësore publike të datës 19.07.2023, pag. 23, faqe nr. 8.

¹² Neni 155 i Kushtetutës përcakton: "Taksat, tatimet dhe detyrimet financiare kombëtare e vendore, lehtësimi ose përjashtimi prej tyre i kategorive të caktuara të paguesve, si dhe mënyra e mbledhjes së tyre caktohen me ligj. Në këto raste, ligji nuk mund t'i jepet fuqi prapavepruese".

të ardhur në kuadër dhe për efekt të procesit të rivlerësimit kalimtar, duke penalizuar subjektin e rivlerësimit me moslegjitimimin e kësaj të ardhure.

48. Në vijim të analizës së mësipërme, trupi gjykues çmoi gjithashtu se ndryshimi që ka pësuar ligji nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, me miratimin e ligjit nr. 9161, datë 18.12.2003¹³, sipas të cilit, në nenin 8 të tij, që përcakton të ardhurat e tatueshme, u shtua një paragraf me përmbajtje: g) të ardhura të tjera, që nuk identifikohen në format e paraqitura në këtë nen, të realizuara nga individë rezidentë ose nga persona jorezidentë, por me burim në Republikën e Shqipërisë – nuk duhet t’i nënshtrohet një interpretimi të zgjeruar, me rezultat përcaktimin e detyrimit për pagesën e tatimit për të ardhurat e krijuara, si pasojë e transaksioneve të shitblerjeve të automjeteve në kushtet e paqartësisë lidhur me shkallën tatimore, bazën e tatueshme, mënyrën e pagesës dhe agjentin tatimmbledhës.

° Lidhur me të ardhurat e përfituara nga dhënia në përdorim e pasurisë “njësi shërbimi” për vitin 2008, në vlerën e 295.000 lekëve

49. Në lidhje me pretendimin e subjektit të rivlerësimit për vlerësim të gabuar dhe të pabazuar në ligj nga ana e Komisionit, të çështjes së të ardhurave të përfituara nga dhënia në përdorim e pasurisë “njësi shërbimi” për vitin 2008, në vlerën e 295.000 lekëve, sipas parashtrimit të bërë në paragrafët 31-32 më sipër në këtë vendim, trupi gjykues, pasi verifikoi aktet e fashikullit të çështjes, konstatoi dhe vlerësoi si vijon.
50. Subjekti i rivlerësimit në deklaratën periodike të vitit 2008, në rubrikën e të ardhurave dhe angazhimeve, ka deklaruar edhe: *Të ardhura nga dhënia në përdorim e ambientit tek {***}, Dega e Infermierisë Gjirokastër, prill-shtator 2008. Për muajt në vazhdim, nuk është kryer ende pagesa. Kontratë qiraje nuk është lidhur.* Në krah, në rubrikën e vlerës, subjekti ka deklaruar: *Muaji prill 2008 – 45.000 lekë, maj 2008 – 50.000 lekë, korrik 2008 – 50.000 lekë, gusht 2008 – 50.000 lekë, shtator 2008 – 50.000 lekë; total 295.000 lekë.*
51. Faktin e dhënies në përdorim të pasurisë “njësi shërbimi”, subjekti rezultoi ta ketë deklaruar edhe në rubrikën e “Ndryshimeve të pasurive [...]”, në të njëjtën deklaratë periodike, si vijon: *Ambient me sipërfaqe 50 m², i destinuar për laborator mikrobiologjik të bashkëshortit [...] Ambienti është dhënë në përdorim {***}, Dega Infermieri, prej muajit prill 2008 [...].* Ndërkohë, në deklaratën e pasurisë *vetting*, të ardhurat nga qiraja e njësisë së shërbimit janë deklaruar për periudhat prill 2008 - mars 2009 dhe 2011 – 2014, në vlerën totale prej 2.173.000 lekësh.
52. Në mbështetje të deklarimeve të bëra në deklaratën e pasurisë *vetting*, në përmbushje të detyrimit të përcaktuar në nenin 32, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit ka dorëzuar bashkëlidhur kësaj deklarate, edhe:

¹³ Ligji nr. 9161, datë 18.12.2003, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar.

(i) Një deklaratë noteriale, datë 29.01.2015, me nr. {***} rep., dhe nr. {***} kol., të dhënë nga O. I., në cilësinë e ish-administratores së {***}, Dega Infermieri, Gjirokastër, përpara noterit publik G. E. B.. Në këtë akt, para noterit publik, znj. O. I. ka deklaruar: *Unë, shtetasja O. I., deklaroj në përgjegjësinë time të plotë se: Në vitin 2008-2009, kam ushtruar detyrën e administratores dhe menaxhueses për {***}, Dega e Infermierisë, Gjirokastër. Deklaroj se në këtë periudhë, kemi marrë në përdorim një ambient me sipërfaqe 50 metër katror, të ndodhur në afërsi të Spitalit Rajonal Gjirokastër, nga shtetasi A. B.. Ambienti është marrë në përdorim në periudhën prill 2008 – mars 2009 dhe është paguar një shumë prej 50.000 lekësh në muaj.*

(ii) Një mandatpagesë të kryer pranë Bankës Kombëtare Tregtare, më datë 23.05.2014, në llogari të Tatim Taksave, me përshkrimin: *A. B. sa derdh pagesë tatim qiraje prill 2008 deri¹⁴ zyrove (marrë me qira nga subjekti “{***}”).*

53. Pagesa e tatimit mbi të ardhurat nga qiraja u provua gjatë hetimit administrativ edhe nëpërmjet shkresës së Drejtorisë së Kontrollit Tatimor të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve nr. {***} prot., datë 21.07.2017, drejtuar ILDKPKI-së, me anë të së cilës është informuar ky i fundit se nga verifikimi i kryer në sistemin tatimor Ec@ts, u ka rezultuar se A. B. ka paguar tatim qiraje për zyrat e dhëna me qira te subjekti “Kristal”, për periudhën 2008-2009, në shumën 60.000 lekë.
54. Gjatë procedurës së hetimit të kryer në Komision, subjekti i rivlerësimit, në përgjigjet e dhëna për pyetësorin nr. 2, është shprehur lidhur me këtë marrëdhënie qiramarrjeje: *Në lidhje me ambientin e shërbimit, sqaroj se nuk është vepruar për pjesëtimin de jure të ambientit në dy pjesë [...]. Qiramarrësi i parë ka qenë {***} (Dega e Infermierisë) Gjirokastër. Për nevoja të krijimit të dy klasave, qiramarrësi ka kërkuar prej fillimit që ambienti të ndahej me gips në dy pjesë, me hyrje të veçanta, dhe për këtë qëllim është bërë ndarja e thjeshtë faktike e ambientit. Edhe pas largimit të {***}, njësia e shërbimit në fakt ka funksionuar si e ndarë në dy pjesë. [...] Pagesa e qirasë është kryer me lekë në dorë nga qiramarrësit të bashkëshortit A. B.. Sa i takon subjektit {***}, nuk është formalizuar qiradhënia me akt noterial apo kontratë të thjeshtë, gjë e cila nuk cenon vlefshmërinë e veprimit sipas normave materiale civile. Për efekt provueshmërie, ju përcjell deklaratën noteriale nr. {***} rep., {***} kol., datë 29.01.2015, të shtetas O. A. I., me detyrë administratore dhe menaxhere për vitet 2008-2009 e {***}, Dega Infermieri, Gjirokastër, e cila ka kryer dhe pagesat.*
55. Në kuadër të shpjegimeve të dhëna lidhur me “Rezultatet e hetimit administrativ”, subjekti i rivlerësimit, sa i takon dyshimit të Komisionit për një trajtim preferencial nga ana e shoqërisë ndërtuese, e cila i ka shitur subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortit të saj dy pasuritë e paluajtshme të llojit “apartament banimi” dhe “njësi shërbimi”, është shprehur edhe në raport me dhënien me qira të “njësisë së shërbimit” {***}, përpara fitimit të titullit të pronësisë mbi këtë send të paluajtshëm: *Në arsyet e dhëna nga ana juaj, që ju kanë krijuar dyshime për trajtim preferencial, ka qenë dhe fakti i shfrytëzimit të njësisë para lidhjes së kontratës së shitblerjes. Në këtë pikë ju sqaroj se, mes palëve ka pasur një marrëveshje për tjetërsimin në të ardhmen të*

¹⁴ Nuk lexohet për shkak të printimit jo të mirë të mandatit bankar.

pasurisë, e garantuar me pagimin e një kapari në shumën 1.000.000 lekë, sipas përcaktimeve të neneve 601, 706 të Kodit Civil. Interesat e shoqërisë ndërtuese, nisur nga veprimtaria ekonomike që ushtronte, konsistonin në shitjen e pasurisë dhe jo në shfrytëzimin e saj. [...] mendoj që administratori na lejoi ta jepnim ambientin në përdorim të persona të tretë, pasi së pari, shoqëria nuk dëmtohej nga një veprim i tillë dhe së dyti, me të ardhurat që do merrnim do të paguheshin detyrime ndaj shoqërisë. Këtë fakt e konfirmon administratori, z. P., në deklaratën noteriale nr. {***} rep., {***} kol., datë 02.07.2020. Në vijim të këtyre shpjegimeve, subjekti i rivlerësimit ka kërkuar të administrohet në cilësinë e provës edhe deklarata noteriale nr. {***} rep., {***} kol., datë 02.07.2020, e administratorit të shoqërisë “{***}” ShPK, z. A. P.. Referuar kësaj deklaratë noteriale, z. A. P. ka deklaruar: *Unë A. P. kam ushtruar detyrën e administratorit “{***}” ShPK, me aktivitet në fushën e ndërtimit. Në janar të vitit 2008, kam lidhur një marrëveshje për shitjen e dy pasurive të llojit apartament banimi dhe njësi shërbimi (zyrë) me shtetasin A. A. B.. [...] Për sa i takon pagesës, shtetasi A. A. B. ka paguar në muajin janar 2008 shumën prej 1.000.000 (një milion) lekësh, ndërsa pjesën e mbetur e ka paguar kur janë nënshkruar kontratat e shitjes në janar të vitit 2009. [...] Nga ana e shtetasit A. A. B., na është kërkuar që të japë me qira ambientin zyrë para lidhjes së kontratës së shitjes dhe nga ana e shoqërisë nuk ka pasur kundërshtime.*

56. Në analizë të sa më sipër konstatuar, trupi gjykues vlerësoi se ka të dhëna të dokumentuara jashtë kontekstit të procesit të rivlerësimit, të cilat tregojnë për përdorimin e ambienteve të pasurisë “njësi shërbimi”, të blerë nga z. A. B., nga {***} dhe krijojnë bindjen se trupi gjykues për dhënien në përdorim të kësaj pasurie gjatë periudhës objekt kontrolli. Vlerësimi lidhur me ligjshmërinë apo jo të të ardhurave të deklaruara nga ana e subjektit të rivlerësimit në deklaratën periodike të vitit 2008, si të krijuara nga dhënia me qira e “njësisë së shërbimit”, të konfirmuara në deklaratën e pasurisë *vetting*, si dhe gjatë procedurës së hetimit administrativ në Komision, në çmim të trupit gjykues, është një çështje fakti dhe duhet të ishte vlerësuar nga Komisioni si e tillë, në drejtim të analizës nëse të dhënat e administruara gjatë hetimit administrativ krijojnë apo jo bindjen se marrëdhënia e përdorimit/qiradhënies kishte ndodhur, sikundër pretendohet nga subjekti i rivlerësimit dhe jo si është arsyetuar nga ana e Komisionit, si një çështje ligji, në drejtim të “*mungesës së legjitimitetit*” për të përfituar shumat monetare të deklaruara, në kushtet kur qiradhënia e sendit pretendohet të ketë ndodhur në një periudhë përpara fitimit të titullit të pronësisë nga qiradhënësit.
57. Në arritjen e këtij konkluzioni, trupi gjykues mbajti parasysh parashikimet e Kodit Civil mbi posedimin, i cili është institut i së drejtës mbi sendin dhe përkufizohet¹⁵ si sundim efektiv i një personi mbi një send dhe mbi të drejtat e tjera reale mbi atë, si dhe të drejtat e poseduesit për të ardhurat e krijuara nga posedimi ku, referuar nenit 297 të Kodit Civil¹⁶ përcaktohet se poseduesit

¹⁵ Shih nenin 304 të Kodit Civil, i cili përcakton shprehimisht: “Posedimi është sundimi efektiv i një personi mbi një send dhe mbi të drejtat e tjera reale mbi atë. Posedimi mund të ushtrohet drejtpërsëdrejti ose nga një person që mban sendin”.

¹⁶ Në nenin 297 të Kodit Civil, përcaktohet: “Poseduesit me mirëbesim i takojnë frutat natyrore të veçuara dhe frutat civile të vjela që janë bërë të kërkueshme deri në ditën që ka marrë dizeni se është posedues i paligjshëm, ose që i është njoftuar padia e pronarit për kërkimin e sendit. Ai nuk detyrohet të shpërblejë pronarin për humbjen, dëmtimin

me mirëbesim i takojnë jo vetëm frutat natyrore, por edhe frutat civile të vjela (ku në rastin objekt gjykimi, si frute civile kuptohen të ardhurat e krijuara nga një marrëdhënie juridike përdorimi/posedimi sendi përkundrejt pagesës). Në kuadër të analizës së mësipërme, deklarata e dhënë nga përfaqësuesi i pronarit të sendit të paluajtshëm, (z. P. në cilësinë e administratorit të shoqërisë ndërtuese “{***}” ShPK), referuar parashikimeve të nenit 298 të Kodit Civil¹⁷, u vlerësua nga trupi gjykues si tregues i një marrëdhënieje posedimi, e cila më së paku nuk ka qenë posedim në keqbesim (një nga rastet e posedimit të paligjshëm). Për rrjedhojë, trupi gjykues arriti në përfundimin se Komisioni ka arritur në konkluzion të pabazuar në fakte dhe në ligj, teksa nuk ka njohur si të ardhura të ligjshme të ardhurat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit në vlerën e 295.000 lekëve të krijuara gjatë periudhës prill-dhjetor 2008, nga dhënia në përdorim e “njësisë së shërbimit” {***}.

58. Në lidhje me pretendimin e Komisionerit Publik në drejtim të përlllogaritjes së gabuar nga ana e Komisionit të shpenzimeve të jetesës për vitin 2007, trupi gjykues e gjeti të drejtë dhe të bazuar këtë pretendim të Komisionerit Publik, në harmoni edhe me jurisprudencën e deritanishme të Kolegjit, sipas së cilës shpenzimet e jetesës edhe për vitin 2007, duhen përlllogaritur sipas standardit të ILDKPKI-së, bazuar në të dhënat e INSTAT-it, si të dhëna të standardizuara, sa më sipër në përputhje edhe me parashikimet e nenit 49, pika 4 e ligjit nr. 84/2016. Për rrjedhojë, ky konkluzion u mbajt në konsideratë nga trupi gjykues edhe gjatë vlerësimit të zërit përkatës të analizës financiare të këtij viti.
59. Sa i takon pretendimit të Komisionerit Publik në lidhje me nevojën për rillogaritjen e shpenzimeve të udhëtimit jashtë vendit, në përputhje me metodologjinë e Kolegjit, të përcaktuar në vendimin e tij (JR) nr. 11/2019, trupi gjykues kreu verifikimet e nevojshme nëpërmjet Njësisë së Shërbimit Ligjor lidhur me saktësinë e përlllogaritjes së këtyre shpenzimeve nga ana e Komisionit, duke përjashtuar nga ky zë shpenzimet që u atribuoheshin udhëtimeve të personit të lidhur, z. A. B., kur ka udhëtuar i vetëm, brenda ditës, me destinacion qytetin e Janinës, Greqi, të cilat u konsideruan nga trupi gjykues në funksion të marrëdhënies së tij me laboratorin privat “{***}”, sa kohë nga aktet e depozituara nga subjekti i rivlerësimit, znj. Irena Brahimi, në mbështetje të pretendimeve lidhur me këto udhëtime jashtë vendit të bashkëshortit të saj, u provua marrëdhënia e këtij të fundit si drejtues teknik i laboratorit mjekësor “{***}”¹⁸, pavarësisht se referuar analizës së kryer më

ose pamundësinë e kthimit të sendit për çdo shkak tjetër, por pas kësaj dite ai përgjigjet për frutat e vjela ose që duhet të kish vjelë, duke vepruar me përkujdesje deri në kohën e kthimit të sendit, për shpërblimin për përdorimin e sendit, si dhe për humbjen, dëmtimin ose pamundësinë e kthimit për faj të tij”.

¹⁷ Në nenin 298 të Kodit Civil, përcaktohet: “Poseduesi, me keqbesim për gjithë kohën e posedimit të tij, detyrohet t’i kthejë pronarit bashkë me sendin, edhe frutat natyrore të veçuara e frutat civile të vjela ose që janë bërë të kërkueshme, dhe të ardhurat e tjera që duhej të vilte, si dhe të shpërblejë pronarin për përdorimin e sendit dhe për humbjen, dëmtimin ose pamundësinë e kthimit të sendit qoftë dhe pa fajin e tij.

Ai shkarkohet nga përgjegjësia kur provon se dëmi do të shkaktohej edhe sikur të kishte dorëzuar sendin në kohën e duhur, përveç kur ai është marrë me anë vepre penale”.

¹⁸ Shih licencën nr. {***}, datë 10.05.2006, lëshuar për laboratorin mjekësor “{***}” dhe licencën nr. {***}, datë 28.05.2008, lëshuar për laboratorin mikrobiologjik “{***}” nga Komisioni i Dhënies së Licencave Profesionale pranë Ministrisë së Shëndetësisë.

sipër në këtë vendim, nuk u arrit të provohet fakti i krijimit të të ardhurave nga ky bashkëpunim i personit të lidhur me këtë subjekt për periudhën e viteve 2006-2007.

60. Në lidhje me pretendimin e subjektit të rivlerësimit për të konsideruar si shpenzim arredimi vlerën prej 900.000 lekësh, si pjesë përbërëse të punimeve shtesë për apartamentin në Gjirokastrë, të deklaruar në deklaratën periodike të vitit 2008 dhe atë të pasurisë *vetting*, në vlerën prej 1.650.000 lekësh, trupi gjykues çmoi se ky pretendim, përveçse mbeti në nivel deklarativ dhe nuk u arrit të provohet nga ana e subjektit të rivlerësimit gjatë gjykimit në Kolegj, rezultoi se binte ndesh edhe me deklarin e kryer nga vetë subjekti i rivlerësimit në deklaratën periodike të vitit 2008, para ILDKPKI-së, të cilën me të drejtë Komisioni e kishte vlerësuar në cilësinë e provës, në përputhje me parashikimin e nenit 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016. Si pasojë e sa më sipër, trupi gjykues e gjeti të drejtë dhe të bazuar qëndrimin e Komisionit në vendim, sipas të cilit shpenzimet e arredimit ishin pasqyruar si një zë i veçantë në analizën e Komisionit, në vlerën e 1.250.000 lekëve, referuar deklarin të vetë subjektit të rivlerësimit (shih përgjigjet e pyetësorit standard të Komisionit, datë 23.01.2019), pa asnjë pikëprerje me vlerën e punimeve shtesë, e cila ishte përfshirë në vlerën e apartamentit si zë i veçantë (pranuar kjo qasje edhe nga subjekti i rivlerësimit, znj. Irena Brahimi, në shpjegimet e saj ndaj “Raportit mbi rezultatet e hetimit administrativ¹⁹). Në vlerësimin e trupit gjykues, ky qëndrim mbështetet edhe nga vetë deklarimi periodik i subjektit të rivlerësimit, znj. Irena Brahimi, të kryer para ILDKPKI-së në vitin në të cilin është krijuar pasuria objekt kontrolli, ku vetë kjo e fundit, punimeve shtesë u ka dhënë kuptimin e shpenzimeve që lidhen me nevojën për përfundimin e apartamentit dhe jo arredimin e tij, duke deklaruar shprehimisht: *Apartament banimi, ndodhur në lagjen “{***}”, Gjirokastrë [...]. Blerë nga shoqëria ndërtuese “{***}” ShPK, me sip. 95,30 m², kati i katërt i banimit. Kontrata e shitblerjes nr. {***} rep., {***} kol., dt. 24.12.2008. Në apartament janë kryer punime shtesë. Çmimi i blerjes është 2.859.000 lekë. Vlera e punimeve shtesë është 1.650.000 lekë. Totali i vlerës së apartamentit është 4.509.000 lekë. [...] Apartamenti dhe ambienti janë marrë jo të përfunduar në janar 2008 dhe është vazhduar me punimet shtesë.*
61. Në përfundim të analizës së mësipërme, pasi u rishikuan zërat e analizës financiare të Komisionit nëpërmjet Njësisë së Shërbimit Ligjor, në përputhje me konkluzionet e arritura nga trupi gjykues në kuadër të shqyrtimit të pretendimeve të Komisionit Publik dhe subjektit të rivlerësimit lidhur me ligjshmërinë e krijimit të pasurive të paluajtshme të llojit “apartament banimi” me sipërfaqe 95,30 m², si dhe “njësi shërbimi” me sipërfaqe 50 m², me vendndodhje në Gjirokastrë, rezultoi se për krijimin e kursimeve familjare në gjendje *cash*, në shumën e 2.300.000 lekëve, si akumulim i kursimeve për periudhën 2005-2007 dhe kursimeve *cash* të realizuara gjatë vitit 2008, në shumën e 1.100.000 lekëve, të deklaruara këto si burim për krijimin e dy pasurive të paluajtshme objekt kontrolli, subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të rezultuan me mungesë të burimeve të ligjshme, respektivisht në shumat 855.000 lekë dhe 98.663 lekë, në total me një mungesë të burimeve të ligjshme në shumën e 953.672 lekëve.

¹⁹ Shih pikën 4 të pjesës I, “Rivlerësimi i pasurisë”, f. 12-13 të shpjegimeve të subjektit të rivlerësimit ndaj rezultateve të hetimit administrativ.

62. Lidhur me shkakun e ankimit të Komisionerit Publik për hetim të paplotë të Komisionit në lidhje me shpenzimet për shkollimin e fëmijëve të subjektit të rivlerësimit, në Shqipëri dhe në Mbretërinë e Bashkuar, trupi gjykues konstatoi dhe vlerësoi si vijon.
63. Komisioneri Publik pretendoi se në analizën financiare të kryer nga Komisioni, shpenzimet e shkollimit të fëmijëve të subjektit të rivlerësimit jashtë Shqipërisë, janë llogaritur bazuar vetëm në deklaratimet e subjektit dhe se nuk rezultoi të jenë administruar akte provuese nga institucionet arsimore lidhur me sa pretendohet në mënyrë deklarative nga subjekti i rivlerësimit për: (i) bursat e përfituara nga këto institucione; (ii) tarifatat e shkollimit, akomodimit; si dhe (iii) shpenzimet e jetesës të kryera nga fëmijët e subjektit të rivlerësimit, znj. Irena Brahimi, brenda dhe jashtë Shqipërisë.
64. Në mbështetje të këtij shkak ankimi, Komisioneri Publik pretendoi se duke iu referuar të dhënave në *open source data* (faqja zyrtare në internet e institucionit privat arsimor “{***}” Londër), rezultonte se tarifatat e këtij institucioni për studentët ndërkombëtarë për një vit akademik (shkollim, akomodim, shpenzime shtesë) janë të një vlere rreth 50.000 GBP. Sipas Komisionerit Publik, duke marrë në konsideratë informacionin mbi kostot e larta të studimeve, kryesisht në Mbretërinë e Bashkuar, vlerësohej si i nevojshëm administrimi i dokumentacionit ligjor justifikues lidhur me: (i) bursat e përfituara nga këto institucione; (ii) tarifatat e shkollimit, akomodimit; dhe (iii) shpenzimet e jetesës, në mënyrë që të konkludohet mbi mundësinë financiare të subjektit të rivlerësimit për të mbuluar me burime të ligjshme shpenzimet dhe kursimet e kryera për vitet 2014-2016, duke qenë se, sipas tij, këto shpenzime përbënin një zë të konsiderueshëm në analizën financiare për këtë periudhë. Në lidhje me sa më sipër, Komisioneri Publik kërkoi nga Kolegji rivlerësimin e zërave respektivë të analizës financiare, në funksion të kontrollit të ligjshmërisë së burimeve financiare që kanë shërbyer për mbulimin e shpenzimeve të realizuara për periudhën 2014-2016.
65. Komisioni nuk rezultoi të ketë arsyetuar në vendimin e tij përfundimtar lidhur me çështjen e shpenzimeve për shkollimin e fëmijëve të subjektit të rivlerësimit, ndërkohë që në dokumentin e “Rezultateve të hetimit kryesisht”, në pjesën që u takonte rezultateve të analizës financiare²⁰, Komisioni është shprehur: *Shpenzimet e shkollimit janë konsideruar sipas deklaratimeve të subjektit të rivlerësimit në deklaratimet periodike.*
66. Në shqyrtim të pretendimit të Komisionerit Publik për hetim të paplotë në drejtim të shpenzimeve të shkollimit të fëmijëve të subjektit të rivlerësimit brenda dhe jashtë Shqipërisë, trupi gjykues e gjeti të drejtë dhe të bazuar këtë shkak ankimi të Komisionerit Publik, pasi nga verifikimi i akteve të fashikullit të përcjellë nga Komisioni, nuk rezultoi që për shpenzimet e shkollimit të kryer në institucionet e arsimit brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, Komisioni të kishte hetuar në drejtim të verifikimit të vlerave të deklaruara si shpenzime shkollimi nga ana e subjektit të rivlerësimit. Gjithashtu, nga shqyrtimi i akteve të fashikullit të Komisionit, nuk rezultoi që të ishin

²⁰ Shih faqen nr. 21 të “Rezultateve të hetimit kryesisht” për subjektin e rivlerësimit, znj. Irena Brahimi.

paraqitur nga subjekti i rivlerësimit akte justifikuese në drejtim të sa më sipër, për vlerat e shpenzuara në institucionet e arsimit të huaj, duke qenë se Komisioni i kishte marrë në konsideratë këto shpenzime sipas deklarimeve të subjektit të rivlerësimit dhe nuk i kishte kaluar asnjë barrë prove në këtë drejtim.

67. Në kuadër të hetimit të zhvilluar në Kolegj lidhur me shpenzimet për shkollimin e fëmijëve të subjektit të rivlerësimit, në Shqipëri dhe në Mbretërinë e Bashkuar, subjekti i rivlerësimit, znj. Irena Brahimi, depozitoi në cilësinë e provës disa akte shkresore të cilat provonin deklarimet e saj lidhur me shpenzimet e kryera në kuadër të shkollimit të fëmijëve në institucionet arsimore brenda dhe jashtë vendit, të cilat, pas analizimit nga trupi gjykues, u konstatuan të jenë të njëjta me vlerat e përlogaritura nga ana e Komisionit. Në kuadër të shqyrtimit të këtij shkak ankimi, trupi gjykues pranoi si të drejtë dhe të bazuar në fakte edhe pretendimin e Komisionerit Publik për të përfshirë në zërin e këtyre shpenzimeve, në analizën e vitit 2016, përveç pagesave të kryera në favor të shkollës “{***}”, në shumën 19.150 GBP, edhe depozitimet në shumën totale prej 900 GBP, të kryera në llogarinë bankare të vajzës së subjektit të rivlerësimit, E. B., pranë Lloyds Bank, në datat 10.10.2016 dhe 14.12.2016.
68. *Lidhur me shkakun e ankimit të Komisionerit Publik se metodologjia e ndjekur nga Komisioni për analizimin e burimeve të ligjshme për periudhën 2014-2016, nuk është e qartë dhe nuk gjen mbështetje në aktet e administruara në dosjen e Komisionit, trupi gjykues konstatoi dhe vlerësoi si vijon.*
69. Në mbështetje të këtij shkak ankimi, Komisioneri Publik pretendoi se:
- 69.1. Bazuar në shkresën e ISSH-së nr. {***} prot., datë 12.12.2018, dhe shkresën e DPT-së nr. {***} prot., datë 01.08.2019, rezulton se bashkëshorti i subjektit, nga punësimi pranë laboratorit privat “{***}”, për periudhën 2014-2016, ka përfituar pagë në masën 3.600 lekë bruto/muaj, dhe jo në shumën 360.000 lekë/vit, siç deklarohet në deklaratën periodike vjetore dhe në vërtetimin e laboratorit.
- 69.2. Përfshirja në mesin e burimeve të ligjshme e të ardhurave të deklaruara me burim nga qiraja e njësisë për vitin 2014, në shumën 432.000 lekë, për të cilat detyrimet tatimore rezulton të jenë paguar në datën 03.03.2020, nuk është në përputhje me jurisprudencën e Kolegjit, që në vendimin nr. 8. datë 16.04.2019, parag. 63, ka mbajtur qëndrimin se: *[...] tatimet e paguara gjatë procesit të rivlerësimit, për të ardhurat e viteve 2006-2012, nuk e bindin trupin gjykues për ligjshmërinë e këtyre të ardhurave, pasi duket qartë që kjo pagesë është bërë për efekt të procesit të rivlerësimit [...].*
- 69.3. Sa u përket pretendimeve të subjektit të rivlerësimit se shpenzimet për udhëtimet e bashkëshortit në drejtim të Janinës janë mbuluar nga laboratorit “{***}”, nga aktet e administruara gjatë hetimit administrativ, nuk rezulton të jenë provuar pretendimet e subjektit lidhur me këto shpenzime. Në vërtetimin e lëshuar nga laboratorit “{***}”, në datën 13.12.2019, në të cilin citohet se punëdhënësi ka përballuar/rimbursuar të gjitha shpenzimet e udhëtimit të kryera nga z. A.B.,

vajtje dhe kthim brenda ditës, me destinacion në Janinë, nuk identifikohen datat e sakta të udhëtimeve të kryera, shumat e rimborsuara, si dhe nuk është dorëzuar ndonjë dokumentacion financiar justifikues.

69.4. Nuk rezulton të jenë përlogaritur shpenzimet për udhëtimet e personave të lidhur, bashkëshortit dhe vajzës së subjektit të rivlerësimit drejt Mbretërisë së Bashkuar në vitin 2016.

70. Në kuadër të ankimit të paraqitur nga Komisioneri Publik, në ankimin e saj, subjekti i rivlerësimit, znj. Irena Brahimi, paraqiti edhe ajo kundërshtimet e saj në drejtim të analizës financiare të kryer nga Komisioni dhe më konkretisht, sa i takon zërit të shpenzimeve të jetesës për vitet 2014, 2015 dhe 2016, me pretendimin se llogaritja e këtyre shpenzimeve duhej bërë për vitin 2014 për familje me tre anëtarë dhe për vitet 2015 dhe 2016 për familje me dy anëtarë, duke qenë se fëmijët e subjektit të rivlerësimit janë larguar për arsye shkollimi.
71. Sa i takon marrëdhënies së punësimit të bashkëshortit të saj, subjekti i rivlerësimit, znj. Irena Brahimi, në ankimin e saj pretendoi se mënyra e pasqyrit në organin tatimor e pagës për vitet 2014-2016, vjen si rrjedhojë e masës së pagës prej 30.000 lekësh, e cila është e përjashtuar nga tatimi mbi të ardhurat. Subjekti i rivlerësimit parashtrroi se në një vlerësim ndryshe nga sa më sipër pretenduar prej saj, paga prej 3.600 lekësh, përpos të qenit një pagë qesharake për një mjek mikrobiolog, drejtues teknik i një laboratorit, do të vinte në kundërshtim edhe me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 573, datë 03.07.2013, “Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi”, gjë të cilën organi tatimor nuk do ta pranonte. Ndërsa gjatë parashtrimeve para trupit gjykues në Kolegj, subjekti i rivlerësimit pretendoi se deklarimi i administratores së laboratorit “{***}” në organin tatimor për periudhën 2014-2016 është i pavërtetë, duke qenë se pagesa e deklaruar prej 3.600 lekësh, i takonte një pagese orare, fakt ky që nuk përkonte me pozicionin e bashkëshortit si drejtues teknik i laboratorit “{***}”, angazhim ky i cili, sipas subjektit të rivlerësimit, ishte me kohë të plotë dhe për të cilin ishin përfituar paga në masën sipas vërtetimeve të dorëzuara prej saj në Komision.
72. Subjekti i rivlerësimit, znj. Irena Brahimi, kundërshtoi si të pabazuar edhe pretendimet e Komisionerit Publik në lidhje me: (i) udhëtimet brenda ditës të bashkëshortit të saj, me destinacion qytetin e Janinës, të cilat, sipas subjektit të rivlerësimit, janë kryer për llogari të punëdhënësit të bashkëshortit të saj dhe shpenzimet e karburantit janë mbuluar prej tij; si dhe (ii) udhëtimin në Mbretërinë e Bashkuar, udhëtim i cili, sipas saj, ka qenë dhe ky brenda ditës, për përcjelljen e vajzës për shkollim dhe sistemimin e saj në konvikt. Sipas subjektit të rivlerësimit, shpenzimi i vetëm i kryer në këtë rast, ka qenë ai i transportit (biletat e avionit), të cilat janë paguar nëpërmjet *overdraft-it* të llogarisë së pagës së saj.
73. Në kuadër të shqyrtimit të këtij shkakui ankimi, trupi gjykues, pasi mori në analizë aktet e administruara në fashikullin e çështjes gjatë hetimit administrativ në Komision dhe gjykimin në Kolegj, vlerësoi se:

73.1 Sa u takon të ardhurave nga punësimi i bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit pranë laboratorit “{***}” për periudhën 2014-2016, pretendimi i Komisionerit Publik për përlogaritje të gabuar nga ana e Komisionit dhe në kundërshtim me standardin e të ardhurave të ligjshme, sipas përcaktimit të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe interpretimit që i ka bërë Kolegji kësaj dispozite në jurisprudencën e saj të deritanishme, është i drejtë dhe i bazuar. Subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë gjatë gjykimit në Kolegj se të ardhurat e përfituara nga bashkëshorti i saj për periudhën objekt deklarimi pranë këtij subjekti privat ishin në masën e deklaruar në deklaratat periodike dhe se për to ishin përmbushur rregullisht detyrimet tatimore përkatëse. Përkundrazi, rezultoi e provuar se deklarimi pranë organit përgjegjës i pagës bruto mujore, mbi bazën e së cilës ishin shlyer edhe detyrimet përkatëse tatimore, ishte në nivel më të ulët sesa pretenduar dhe deklaruar nga subjekti i rivlerësimit. Për rrjedhojë të sa më sipër, trupi gjykues arriti në përfundimin se ndryshe nga Komisioni, vlerësohen si të ardhura të ligjshme në kuptim të standardit të sipërcituar kushtetues dhe ligjor, vetëm të ardhurat e krijuara nga marrëdhënia e punësimit pranë laboratorit “{***}” nga personi i lidhur, z. A. B., për periudhën 2014-2016, në masën e vërtetuar nga institucionet shtetërore. Mbi bazën e këtij konkluzioni, u rishikua në analizën financiare edhe zëri i të ardhurave nga punësimi i bashkëshortit për periudhën objekt kontrolli.

73.2 Sa i takon pretendimit të Komisionerit Publik lidhur me mospërfshirjen si burim të ligjshëm të të ardhurave të krijuara me burim qiranë e njësisë për vitin 2014, në shumën e 432.000 lekëve, me arsyetimin se detyrimet tatimore rezultojnë të jenë paguar në datën 03.03.2020 (gjatë procesit të rivlerësimit), për të cilat Kolegji ka pasur qëndrime në vendimmarrje të mëparshme se një përmbushje e tillë e detyrimeve tatimore gjatë procesit të rivlerësimit nuk krijon bindjen për ligjshmërinë e këtyre të ardhurave, pasi duket qartë që kjo pagesë të jetë bërë për efekt të procesit të rivlerësimit²¹, trupi gjykues, pasi verifikoi aktet e fashikullit të çështjes, konstatoi se subjekti i rivlerësimit, lidhur me të ardhurat e krijuara nga dy kontratat e qirasë, respektivisht: (i) kontrata e lidhur nga z. A. B. dhe R. L., më datë 02.01.2014, për dhënien me qira të njësisë së shërbimit me sip. 25 m², për periudhën 02.01.2014 – 02.01.2015, me çmim qiraje 20.000 lekë/muaj; dhe (ii) kontrata e lidhur nga z. A. B. dhe K. S., më datë 30.05.2013, për dhënien me qira të njësisë së shërbimit me sip. 25 m², për periudhën 30.05.2013 – 30.05.2015, me çmim qiraje 20.000 lekë/muaj, detyrimet që i burojnë lidhur me pagesën e tatimit mbi të ardhurat nga qiraja, sipas parashikimeve të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, i ka provuar sipas mandatarkëtimit të datës 03.03.2020 dhe shpjegimit të dhënë në paragrafin nr. 8 të parashkrimeve në lidhje me raportin “Mbi rezultatet e hetimit administrativ”. Në këtë paragraf, subjekti i rivlerësimit është shprehur: *Depozitoj si provë edhe mandatpagesën, datë 03.05.2020, për pagimin e tatimit për të ardhurat nga qiraja për vitin 2014, për të cilat jam pyetur në pyetësorët e dërguar nga ana juaj [...].* Ndërkohë që në përgjigjet e dhëna lidhur me pyetjen 2 të Komisionit në pyetësorin nr. 2 të tij, datë 28.10.2019, subjekti i rivlerësimit pasi kishte dhënë shpjegime lidhur me kontratat e qirave të lidhura për dhënien me qira të dy ambienteve të pasurisë së paluajtshme të llojit “njësi”, të blerë nga shoqëria ndërtuese “{***}” ShPK, dhe pagesat e tatimeve lidhur me

²¹ Duke iu referuar këtu vendimit të Kolegjit nr. 8, datë 16.04.2019.

këto të ardhura, ishte shprehur se: *për vitin 2014, bashkëshorti nuk kishte arritur të gjejë mandatin, pavarësisht verifikimeve, prandaj dhe i ishte drejtuar me kërkesë Drejtorisë Tatimore Gjirokastrë.*

73.3 Trupi gjykues, pasi vlerësoi marrëdhënien e qiradhënies së dy ambienteve të njësisë së shërbimit ndër vite, si dhe raportin e bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, si përfitues i të ardhurave personale nga qiradhënia, me organin tatimor, në drejtim të përmbushjes së detyrimeve tatimore lidhur me tatimin mbi të ardhurat personale nga aktiviteti i sipërcituar²², si dhe konstatoi faktin se mospagesa në kohë e tatimit për të ardhurat e realizuara nga qiradhënia për vitin 2014, është një rast i izoluar, arriti në përfundimin se në dritën e rrethanave në të cilat është zhvilluar marrëdhënia e qirasë, kjo situatë faktike nuk dëshmon në favor të shmangies së personit të lidhur nga detyrimet tatimore që i ngarkon ligji. Në këtë kontekst, situata faktike në rastin në gjykim u vlerësua e ndryshme nga rastet e tjera të marra në shqyrtim nga Kolegji, kur është provuar se pagesat e tatimeve gjatë periudhës së procesit të rivlerësimit janë kryer për të legjitimuar të ardhura, të cilat në mënyrë të qëllimshme, për t'iu shmangur detyrimeve respektive tatimore, nuk janë deklaruar përpara organeve tatimore, ndryshe nga sa rezultoi më sipër, ku kontrata e qirasë e lidhur nga z. A. B. dhe z. K. S., më datë 30.05.2013, për dhënien me qira të njësisë së shërbimit me sip. 25 m², për një periudhë 2-vjeçare, ishte deklaruar rregullisht në organin tatimor, si dhe pagesa e tatimit për vitin 2013-2014, në vlerën e 48.000 lekëve, sipas së njëjtës kontratë, ishte kryer rregullisht. Në përfundim të sa më sipër, trupi gjykues, bazuar edhe në jurisprudencën e Kolegjit²³, vlerësoi se të ardhurat e krijuara nga dhënia me qira e njësisë së shërbimit në Gjirokastrë në vitin 2014, në shumën e 432.000 lekëve, janë të ardhura të ligjshme në kuptim të standardit kushtetues dhe ligjor dhe duhet të përfshihen në rubrikën e të hyrave/të ardhurave në analizën financiare të vitit korrespondues

73.4 Sa i takon çështjes së përlllogaritjes së shpenzimeve të udhëtimeve jashtë vendit, sipas të dhënave të sistemit TIMS për hyrje-daljet nga Republika e Shqipërisë për periudhën 2014-2016, trupi gjykues mbajti të njëjtin qëndrim dhe i trajtoi pretendimet e palëve lidhur me këto udhëtime sipas të njëjtit standard vlerësimi, si në rastin e pretendimeve për udhëtimet e kryera në periudhën e viteve 2006-2008.

73.5 Sa u takon pretendimeve të subjektit të rivlerësimit në lidhje me reduktimin e vlerave të shpenzimeve të jetesës për vitet 2014 dhe 2016, trupi gjykues i çmoi ato të pabazuara në fakte, sa kohë subjekti i rivlerësimit, znj. Irena Brahimi, nuk arriti të bindë trupin gjykues se përgjatë këtyre viteve, për jetesën e fëmijëve të saj në Tiranë, gjatë periudhës së shkollimit, shpenzimet ishin mbuluar ekskluzivisht nga gjyshërit pensionistë, pa kontribute financiare të prindërve të tyre (subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortit të saj).

²² Nga hetimi i kryer nga ILDKPKI-ja, Drejtoria Rajonale Tatimore Gjirokastrë, në shkresën e saj nr. {***}, datë 21.07.2017, ka përcjellë informacion lidhur me pagesat e kryera nga z. A. B. për tatimin nga qiraja, ku konstatohet se janë kryer pagesa për periudhat 2008-2009, në shumën 60.000 lekë, 2011-2012 në shumën 38.000 lekë, 2012-2013 në shumën 48.000 lekë dhe 2013-2014 në shumën 48.000 lekë.

²³ Shih vendimin e Kolegjit (JR) nr. 15/2021.

74. Në përfundim të analizës së kryer mbi shqyrtimin e shkaqeve të ankimit për vlerësimin e kriterit të pasurisë, në vijim të konkluzioneve të arritura më sipër në këtë vendim, lidhur me çështjet e ngritura nga Komisioneri Publik dhe subjekti i rivlerësimit, trupi gjykues kreu analizën financiare përfundimtare për periudhën 2003-2016, nga ku rezultoi se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të kanë mungesë të burimeve të ligjshme për krijimin e pasurive “apartament” dhe “njësi shërbimi” dhe kryerjen e shpenzimeve në shumën prej 1.170.749 lekësh. Trupi gjykues, duke mbajtur në konsideratë edhe mungesën e burimeve të ligjshme të konstatuar nga Komisioni për periudhën para vitit 2003, në vlerën prej 301.701 lekësh, arriti në konkluzionin se rezultati negativ në vlerën totale prej 1.472.450 lekësh, bazuar në parimin e proporcionalitetit dhe objektivitetit të vlerësimit të situatës faktike specifike të çështjes objekt gjykimi, nuk e cenon besueshmërinë e subjektit të rivlerësimit, lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë.
75. Në këto kushte, trupi gjykues çmoi se subjekti i rivlerësimit, znj. Irena Brahim, ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë së saj dhe të personave të lidhur me të, në kuptim të parashikimeve të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 59, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016.

C. Vlerësimi i shkaqeve të ankimit lidhur me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale

76. Lidhur me pretendimin e ngritur në ankimin e Komisionerit Publik sa i takon transferimit të çështjes civile të shqyrtuar në Gjykatën e Apelit Gjirokastrë dhe të përfunduar me vendimin nr. {***}, datë 12.05.2015, trupi gjykues konstatoi se sa pretenduar në ankim nga Komisioneri Publik në lidhje me mospasqyrimin në pjesën përshkruese/arsyetuese të vendimit të korigjimit nr. 276/1, datë 19.10.2020, të rrethanave të çështjes së sipërcituar civile dhe shkaqeve për të cilat është vendosur nga Komisioni transferimi i saj për inspektim pranë organit kompetent, në përputhje me pikën 4 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016, është një pretendim i bazuar në fakte dhe, për rrjedhojë, Komisioni në këtë rast vlerësohet të mos ketë respektuar urdhërimin e nenit 57 të ligjit nr. 84/2016, në lidhje me elementet e përmbajtjes së pjesës përshkruese-arsyetuese të vendimit nr. 276/1, datë 19.10.2020, që korigjonte vendimin nr. 276, datë 21.07.2020, objekt ankimi në Kolegj, me pasojë cenimin e standardit të arsytimit të vendimit të korigjimit e, si rrjedhojë, të vendimit objekt kontrolli. Për rrjedhojë të sa më sipër, ky gabim procedural i Komisionit, referuar parashikimeve të nenit F, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, çmohet i korigjuar nga Kolegji nëpërmjet gjykimit në seancë publike, gjatë së cilës u debatuan nga palët pretendimet në lidhje me këtë çështje.
77. Në përfundim të hetimit gjyqësor të çështjes lidhur me kriterin e aftësive profesionale, Komisioneri Publik, duke mbajtur parasysh vendimin e Kolegjit (JR) nr. 49, datë 20.12.2022, i cili ka trajtuar problematikën e çështjes civile të transferuar nga Komisioni pranë organit kompetent për inspektim, si dhe pasi u njoh me fashikullin e çështjes penale të administruar në kuadër të një denoncimi publik që kishte përfshirë si pjesë të ankimit të tij, arriti në konkluzionin se problematikat e tyre nuk cenojnë konkluzionin e Komisionit lidhur me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, znj. Irena Brahim.

78. Në këto kushte, trupi gjykues vlerësoi se konkluzioni i Komisionit, se subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, mbetet i pacenuar.
79. Për rrjedhojë, trupi gjykues, në vijim të konkluzioneve të mësipërme, bazuar në nenin 59, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, vlerësoi se vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit për konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, është i bazuar në fakte dhe në ligj dhe, për rrjedhojë, duhet të lihet në fuqi.

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues, bazuar në nenin 66, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, me shumicë votash,

VENDOSI:

1. Lënien në fuqi të vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 276, datë 21.07.2020, që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. Irena Brahimi.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, më datë 24.07.2023, në Tiranë.

ANËTARE

Ina RAMA

nënshkrimi

ANËTARE

Rezarta SCHUETZ

nënshkrimi

ANËTARE

Mimoza TASI

nënshkrimi

RELATOR

Sokol ÇOMO

nënshkrimi

KRYESUESE

Natasha MULAJ

nënshkrimi – kundër

MENDIM PAKICE

1. Unë, gjyqtare Natasha Mulaj, në cilësinë e kryesueses së trupit gjykues, jam kundër vendimit nr. 32, datë 24.07.2023, të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, me të cilin është vendosur lënia në fuqi e vendimit nr. 276, datë 21.07.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. Irena Brahimi, për konfirmimin e saj në detyrën e gjyqtares në Gjykatën e Apelit Gjirokastër.

Shumica e trupit gjykues, në vlerësimin tim, duhet të kishte pranuar shkaqet e ngritura nga Komisioneri Publik në ankim dhe, në përfundim të shqyrtimit të çështjes gjyqësore, të dispononte përfundimisht me shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Irena Brahimi.

Në vijim po parashtoj arsytet ligjore mbi të cilat bazohet bindshmëria për këtë mendim pakice.

Lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë

2. Kundërshtoj diferencën negative të konkluduar nga shumica e trupit gjykues në vlerën 1.472.450 lekë, e cila në vlerësimin tim ka përmirësuar situatën financiare të subjektit të rivlerësimit deri në kufijtë e favorizimit. Çmoj se rezultati financiar i arritur nga shumica e trupit gjykues është pasojë e një vlerësimi të gabuar të ligjshmërisë së akteve të administruara në dosjen gjyqësore, si dhe e metodologjisë së përdorur në përllogaritjet e indikatorëve të përfshirë në analizë financiare, konkretisht shpenzimeve të udhëtimit të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit A. B. për periudhën 2005 - 2016, si dhe të ardhurave nga qiraja në vitin 2014.
3. Lidhur me shpenzimet e udhëtimit të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit me destinacion Janinë, Greqi, brenda ditës, konsideroj të pabazuar përllogaritjen e tyre në analizën financiare të konkluduar nga shumica, në vlerën 0 (zero) lekë, pasi subjekti i rivlerësimit nuk paraqiti asnjë dokument ligjor për të provuar se këto shpenzime udhëtimi janë mbuluar nga laboratorit mjekësor “{***}”. Gjithashtu, mbetet në kontekst deklarativ pretendimi i subjektit të rivlerësimit se bashkëshorti ka kaluar në shtetin grek vetëm për arsye pune. Në këto kushte, shumica e trupit gjykues minimalisht duhet të kishte vepruar në përputhje me qëndrimin e Kolegjit në jurisprudencën e tij deri aktualisht. Efekti financiar i këtyre shpenzimeve në vlerën (-) 769.091 lekë, afekton mundësinë për krijimin e kursimeve *cash* të subjektit të rivlerësimit, me pasojë thellimin e rezultatit negativ të konstatuar nga shumica e trupit gjykues, në masën (-) 2.241.541 lekë. Përkeqësimi i situatës financiare deri në këtë vlerë, vendos subjektin e rivlerësimit në kushtet e zbatimit të nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016 e, për rrjedhojë, në deklaram të pamjaftueshëm të pasurisë sipas nenit 61, pika e 3 e këtij ligji.
4. Lidhur me të ardhurat e përfituara nga qiradhënia e dy ambienteve të njësisë së shërbimit në vitin 2014, në drejtim të përmbushjes së detyrimeve tatimore, në ndryshim nga shumica e trupit gjykues, çmoj mospërfshirjen e kësaj të ardhure mes të ardhurave të ligjshme, për arsye se: *së pari*, nuk përmbushen kërkesat e nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, dhe *së dyti*, nuk është paraqitur asnjë pretendim bindës përse kjo pagesë është kryer pikërisht gjatë periudhës së rivlerësimit, që vjen në kundërshtim me qëndrimin e Kolegjit në jurisprudencën e tij (vendimi (JR) nr. 49/2022,

paragrafi 16.12), në të cilin nuk ka konsideruar të ardhura të ligjshme nga qiraja ato për të cilat detyrimet tatimore rezultojnë se janë paguar gjatë dhe për qëllim të procesit të rivlerësimit. Me këtë arsyetim, situata financiare e subjektit të rivlerësimit do të përkeqësohej edhe me (-) 432.000 lekë.

5. Me arsyetimin më sipër, shumica e trupit gjykues ka shkelur haptazi kërkesat e ligjit dhe praktikën e ndjekur nga Kolegji për dy problematikat e analizuara më sipër, duke konsideruar të ardhurat nga qiratë, edhe pse tatimi është paguar gjatë procesit të rivlerësimit të subjektit në Komision dhe duke përlllogaritur shpenzimet e udhëtimit të bashkëshortit të subjektit në vlerën zero (0) lekë. Nisur nga ky fakt, vlerësoj se shumica e trupit gjykues, me vendimmarrjen e saj, është munduar të përmirësojë situatën financiare të subjektit të rivlerësimit deri në atë pikë sa të bënte të zbatueshëm parimin e proporcionalitetit.

Lidhur me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale

6. Në cilësinë e gjyqtarës në pakicë, çmoj se Komisioni ka interpretuar dhe zbatuar në mënyrë të gabuar nenin 59, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, duke transferuar çështjet pranë organit kompetent për inspektim, ndërkohë që çdo vendimmarrje të subjekteve përgjatë procesit të rivlerësimit duhet ta bënte objekt të kontrollit të tij. Komisioni ka krijuar një precedent të gabuar duke favorizuar subjektet e rivlerësimit, sidomos në rastin e shkeljeve të konstatuara për të cilat nga koha e kryerjes së tyre deri në momentin e dhënies së vendimit të Komisionit, ka kaluar afati 5-vjeçar dhe disponimi për transferimin e tyre do të rezultonte pa efekt, në kushtet kur organi kompetent për inspektim, në zbatim të nenit 117, nenit 120, pika 1, shkronja “b” dhe nenit 121, pika 2, shkronja “a” e ligjit nr. 96/2016, do të arkivonte praktikën. Këtë precedent, në vlerësimin tim, duhet ta korrigjojë Kolegji, detyrim që ia parashikon ligji nr. 84/2016, në nenin 66, pika 2 e tij, nëpërmjet orientimit të Komisionit lidhur me këto vendimmarrje të gabuara.
7. Në rastin objekt shqyrtimi, qëndrimin e shumicës së trupit gjykues në vendim se: *77. Komisioneri Publik, duke mbajtur parasysh vendimin e Kolegjit (JR) nr. 49, datë 20.12.2022, i cili ka trajtuar problematikën e çështjes civile të transferuar nga Komisioni pranë organit kompetent për inspektim, si dhe pasi u njoh me fashikullin e çështjes penale të administruar në kuadër të një denoncimi publik, që kishte përfshirë si pjesë të ankimit të tij, arriti në konkluzionin se problematikat e tyre nuk cenojnë konkluzionin e Komisionit lidhur me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, znj. Irena Brahim.* *78. Në këto kushte, trupi gjykues vlerësoi se konkluzioni i Komisionit, se subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, mbetet i pacenuar, e konsideroj të pabazuar në ligj dhe në kundërshtim me qëllimin e procesit të rivlerësimit për rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e sistemit të drejtësisë. Juridiksioni i rivlerësimit është një juridiksion kushtetues i një natyre të veçantë administrative e, në këto kushte, pavarësisht se Komisioneri Publik, të cilit dispozitat kushtetuese i kanë atribuar të drejtën e mbrojtjes së interesit publik, tërhiqet nga kërkesat e tij, gjykata, në këtë rast Kolegji, nuk duhet kurrsesi të orientohet në drejtim të*

moskryerjes së vlerësimit për ato raste që Komisioneri Publik i adreson në ankim, e që më pas bindet se nuk cenon vendimin e Komisionit, pa e argumentuar ligjërisht.

8. Konkluzioni i Komisionerit Publik, lidhur me çështjen civile të shqyrtuar në Gjykatën e Apelit Gjirokastër, përfunduar me vendimin nr. {***}, datë 12.05.2015, si dhe çështjen penale me të pandehur z. H. D., për veprën penale “Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor”, të parashikuar nga neni 290, pika 4 e Kodit Penal, në gjykimin tim nuk është detyrues për Kolegjin, që është gjykata e vetme që vlerëson dhe disponon përfundimisht për çështjet e ngritura para saj, pasi ia ka nënshtruar kontrollit gjyqësor.

9. Si gjyqtare në pakicë, çmoj se problematikat e konstatuara në çështjen civile të shqyrtuar në Gjykatën e Apelit Gjirokastër, përfunduar me vendimin nr. {***}, datë 12.05.2015, të bëra prezente në vendimin (JR) nr. 49, datë 20.12.2022, të Kolegjit dhe mendimin e pakicës së tij, duhet të ishin përfshirë në vlerësimin në tërësi të kriterit të aftësive profesionale edhe për subjektin e rivlerësimit, znj. Irena Brahimi, pavarësisht cilësisë së saj si anëtare e trupit gjykues në vendimmarrjen e çështjes civile, duke i vlerësuar së bashku me problematikat që do të rezultojnë nga shqyrtimi i çështjes penale me të pandehur z. H. D., për veprën penale “Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor”, të parashikuar nga neni 290, pika 4 e Kodit Penal, i deklaruar fajtor dhe dënuar me 6 vjet burgim nga Gjykata e Shkallës së Parë Gjirokastër, vendim të cilin Gjykata e Apelit Gjirokastër, me përbërje të trupit gjykues subjektin e rivlerësimit në cilësinë e relatores, e ndryshoi duke e deklaruar të pafajshëm. Një vendim tejet i dyshimtë dhe i diskutueshëm lidhur me shpalljen të pafajshëm të një personi të përfshirë në një ngjarje që mori një jehonë të gjerë mediatike për shkak të humbjes së jetës së tre personave, mes të cilët dy të mitur dhe plagosjen e 7 (shtatë) personave të tjerë. E them të dyshimtë, pasi vendimet penale të kësaj natyre kanë për bazë aktet e ekspertimit të kryera, të cilat evidentojnë fajësinë ose pafajësinë e autorëve të veprës penale. Në rastin konkret, përgjatë hetimit paraprak janë kryer dy aktekspertime dhe përgjatë hetimit gjyqësor të çështjes në Gjykatën e Shkallës së Parë Gjirokastër, është kryer edhe një aktekspertim tjetër. Në tri aktekspertimet e kryera, rezultojnë kontradikta, ama i pandehuri H. D. gjithsesi ngarkohet me faj. Prokuroria në të dyja shkallët e gjykimit kërkon fajësinë e të pandehurit, duke qenë se me veprimet e tij ka kryer shkelje të rregullave të qarkullimit rrugor, me pasojë vdekjen e tre personave dhe plagosjen e disa të tjerëve. Në gjykimin e çështjes në apel, subjekti i rivlerësimit, znj. Irena Brahimi, në cilësinë e kryesueses/relatores së çështjes, ka ndryshuar vendimin e shkallës së parë duke e deklaruar të pafajshëm të pandehurin H. D..

Në gjykimin tim, shumica e trupit gjykues nuk u ndal të bënte një vlerësim profesional lidhur me këtë vendimmarrje të subjektit të rivlerësimit për këtë çështje kaq të rëndë penale, duke e anashkaluar atë, edhe pse mori kohën e nevojshme për administrimin e dosjes penale nga Gjykata e Lartë, duke shtyrë seancën dhe shkelur në këtë mënyrë parimin e ekonomisë gjyqësore. Në përfundim, shumica e trupit gjykues është mjaftuar vetëm me arsyetimin në paragrafin 77 të vendimit: [...] si dhe pasi u njoh me fashikullin e çështjes penale të administruar në kuadër të një denoncimi publik, që kishte përfshirë si pjesë të ankimit të tij, arriti në konkluzionin se problematikat e tyre nuk cenon vendimin e Komisionit lidhur me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, znj. Irena Brahimi [...]. Konstatoj se subjekti i

rivlerësimit gjatë gjykimit të çështjes, edhe pse ka vendosur riçeljen e hetimit gjyqësor, nuk ka kërkuar riekspertim nga një grup ekspertësh, por është mjaftuar vetëm me ripyetjen e ekspertëve që kanë kryer aktekspertimet e mëparshme, me rezultate të paqarta mes tyre dhe ndaj të cilëve Gjykata e Shkallës së Parë Gjirokastrë ka bërë kallëzim penal për konsumim të elementeve të veprës penale “Ekspertim të rremë”, parashikuar nga neni 309 i Kodit Penal. Në këto kushte, vlerësoj se subjekti i rivlerësimit ka vepruar në kundërshtim me legjislacionin procedural penal.

10. Në përfundim të sa arsyetuar më sipër, çmoj se subjekti i rivlerësimit, znj. Irena Brahim, nuk ka justifikuar me burime të ligjshme pasurinë e krijuar dhe nuk arrin nivelin e besueshmërisë në vlerësimin e këtij kriteri, sipas parashikimit të nenit 59, pika 1, germa “a” e ligjit nr. 84/2016, si kusht i domosdoshëm për konfirmimin e saj në detyrë. Në vlerësimin tim, pamjaftueshmëria e burimeve financiare kërkon zbatimin e nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016 dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, znj. Irena Brahim. Konstatimet në kuadër të vlerësimit të aftësive profesionale, sa u përket dy çështjeve të sipërcituara, përforcojnë edhe më shumë bindjen se subjekti i rivlerësimit, referuar kërkesave të ligjit për rivlerësimin, nuk duhet të jetë në radhët e sistemit të drejtësisë.

GJYQTARE

Natasha MULAJ

nënshkrimi